



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(Auditim Përputhshmërie)**

**Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë**

**PRILL, 2021**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI  
(Auditim Përputhshmërie)****Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë**

<b><i>Nr</i></b>	<b><i>Përmbajtja</i></b>	<b><i>Faqe</i></b>	
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>			
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3-4	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-10	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	10-13	
<b>II. HYRJA</b>			
a)	Objektivat dhe qëllimi. ....	13	
b)	Identifikimi i çështjes.....	13	
c)	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	13	
d)	Përgjegjësitë e audituesve.....	13-14	
e)	Kriteret e vlerësimit.....	14	
f)	Standardet e auditimit.....	14	
g)	Metodat e auditimit.....	14-15	
h)	Dokumentimi i auditimit.....	16	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>			
1.	Informacion i përgjithshëm.....	16	
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	16	
2.1	Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit.....	17-30	
2.2	Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit.....	30-44	
2.3	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....		
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....</b>			<b>44-49</b>
<b>V. ANEKSE.....</b>			<b>50-52</b>



### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.810/1, datë 01.09.2020 në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Tiranë, nga data 01.09.2020 –15.10.2020, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.08.2020, u krye auditimi i Përputhshmërisë në MASR. Në bazë të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, sanksionon, për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara, nga studimet të kryera jashtë vendit që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, është detyrim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) si dhe kriteret për njohjen dhe njësimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkuara nga vendi ynë për këtë qëllim. Auditimi u shtri mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit dhe mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit. MASR, është institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave Njësisë së njohjes së diplomave dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) si dhe Komisioneve ad hoc që ngrihen me urdher të Ministrit të MASR për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore, të fituara jashtë vendit.

Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokument, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.

MASR vepron mbi bazën ligjore e mëposhtme:

- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.8834, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë”.
- Ligji nr.10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.
- VKM nr.371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”.
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”.
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.32, datë 29.12.2017 “Disa ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.15, datë 16.04.2018 “Për shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.5, datë 21.02.2019 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.30, datë 30.12.2019 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptar.

## 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>-Sipas ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, sanksionon, njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara, nga studimet të kryera jashtë vendit që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, është detyrim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) si dhe <u>kriteret për njohjen dhe njësimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin</u>, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.</p> <p>-Sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në nenet 9,10 QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.</p> <p>Në vijim u konstatua se, aktet administrative të miratuara nga Ministri i MASR, në funksion të ligjit të mësipërm, për çështjen objekt i këtij auditimi, paraqesin problematikat si më poshtë</p>	16-26	I LARTË	<p>- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si ministria përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore, të iniciojnë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimet e VKM-së nr.371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.1013, datë 10.12.2010, të KM, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, për të bërë të mundur njohjen juridike, funksionale për atributin në fjalë nga QSHA, si struktura që realizon shërbimin e njohjes dhe njësimit e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.</p> <p>- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si ministria përgjegjëse, në bazë të rolit që ka sipas ligjit të arsimit të lartë, të marrë masa për shfuqizimin e Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

<p>vijon:</p> <p><u>-Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, nr.17 datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar (i cili ka pësuar disa herë ndryshime të pjesshme, konkretisht me udhëzimet, nr. 32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019); si dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore QSHA”, kanë bërë të mundur që, MASR të marrë me pa të drejtë kompetencën për transferimin e këtij detyrimi QSHA-së, në një kohë që këtë kompetencë e ka Këshilli i Ministrave. QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9 pika 4, por nga ana tjetër QSHA është krijuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, ku në asnjë pikë të kornizës ligjore, nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit.</u></p> <p><u>-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar, sipas Kreut II, i ka njohur të drejtën QSHA-së, të realizojë procedurën vetëm për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të fituara jashtë vendit, ndërsa procedura për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, realizohet nga MASR, me anë të strukturave jo permanente - sekretariatit teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, të cilat miratohen kohë mbas kohe me Urdhër të Ministrit të Arsimit, në</u></p>		<p>arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, duke hartuar dhe miratuar udhëzime që t’i shërbejnë përcaktimit të kriterëve dhe procedurave, të njohjes dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit.</p> <p>- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si ministria përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore, të iniciojnë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimet e VKM-së nr.371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.1013, datë 10.12.2010, të KM, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, për të bërë të mundur njohjen juridike, funksionale për atributin në fjalë nga QSHA, si struktura që realizon shërbimin e njohjes dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit.</p> <p>- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si ministria përgjegjëse, në bazë të rolit që ka sipas ligjit të arsimit të lartë, të marrë masa për shfuqizimin e Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, duke hartuar dhe miratuar udhëzime që t’i shërbejnë përcaktimit të kriterëve dhe procedurave, të njohjes dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit.</p> <p>- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në hartimin e udhëzimit të ri, të vendoset si detyrim procedura e vulës apostile për njësimin e të gjitha akteve (certifikata, diploma</p>
--	--	--



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

<p>mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92 , pasi Sektori i Njohjes së Diplomave në MASR është suprimuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.163, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.</p> <p>- Udhëzimi nr.17 datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar, Kreu IV,pika 4.1 <u>parashikon njohjen e diplomave , certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, edhe pa vulë apostile, për verifikimin e autenticitetit të diplomave, certifikata dhe gradave shkencore.</u> Mosekzistenca e këtij elementi, ul efikasitetin e sistemeve të kontrollit si dhe lë shteg për abuzime të ndryshme.</p> <p>-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, i ndryshuar, nuk ka në përmbajtje, datën e fillimit të ushtrimit të kompetencave në QSHA, por shprehet se, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare, kreu VIII (Dispozita të fundit) pika 2. Nga auditimi u konstatua se, botimi është bërë më datë 26.04.2018 në fletoren zyrtare nr. 59/2018, ndërsa procesi i njësimin të diplomave është transferuar në QSHA nga MASR, në muajin shtator 2018, duke sjellë “mbivendosje të strukturave”, pasi deri në shtator 2018, këtë funksion e ka realizuar sekretariati teknik pranë MASR.</p> <p>-Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar, numrin minimal të depozitimeve të dosjeve të aplikimeve të gradave shkencore pranë “sekretariatit teknik” si dhe nuk ka të përcaktuar, afatet/kohën që i duhet komisionit ad hoc dhe sekretariatit teknik, për shqyrtimin e dokumentacionit, pasi konstatuam raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin, dhe vendim marrja për njohje/njësim, është bërë mbas disa muajve.</p> <p>-MASR dhe QSHA, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik, për të iniciuar hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, në përputhje me ndryshimet e mësipërme.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim, me ligjin nr. 80/2015 “Për</p>			<p>dhe grada shkencore dhe titujve akademikë), të fituara jashtë vendit, me qëllim forcimin e elementëve të vërtetësisë të dokumentave që do të njësohen.</p>
---	--	--	---



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

	<p>arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenet, 9, 10 dhe 92, me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6 (institucione varësie), me VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga QSHA” dhe me Urdhërin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.</p>			
2	<p>Qendra e Shërbimeve Arsimore, funksionon me Rregullore të brendshme nr.1462 prot datë 02.09.2014, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, e cila nuk reflekton ndryshimet e strukturës sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, ndonëse nga QSHA me shkresën nr. 580 prot., datë 30.01.2019, është dërguar për miratim në MASR, Draft- Rregullore e brendshme, e cila nuk është miratuar nga titullari i MASR.</p> <p>Veprimi i mësipërm është në kundërshtim, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20.</p>	18-20	I LARTË	<p>Qendra e Shërbimeve Arsimore, mbas finalizimit të miratimit të VKM-së për njohjen juridike dhe funksionin e atributit të shërbimit për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit, të marrë masa të propozojë për miratim, rregulloren e re të brendshme të saj, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë duke reflektuar ndryshimet.</p>
3	<p>Nga auditimi u konstatua se, MASR dhe QSHA, për dosjet e aplikimeve për njësim/njohje të certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, kanë vetëm një bazë të dhënash të posaçme, që përmban të dhëna specifike të secilës prej dosjeve të aplikimit, por këto dosje nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar, nenet 24, 36/1, 37, 39 si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.</p>	31-34	I MESËM	<p>Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.</p>



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

4	<p>Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, <u>sektor që deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ekziston</u>, për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik, ku anëtarë janë specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë dhe këtë detyrim shtesë, për të cilin as nuk vlerësohen nga eprori direkt, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 62. Gjithashtu, komisionet Ad hoc dhe sekretariati teknik, ngrihen kohë mbas kohë, me urdhër të titullarit të MASR, pra këto “struktura” nuk janë permanente. Mungesa e një strukture permanente dhe për më tepër angazhimi në komisioni i anëtarëve(profesorë, pedagogë, ekspertë, etj) kundrejt asnjë pagese dhe detyrimi, ka bërë që të ketë pasur raste që anëtarë të komisioneve ad hoc, për arsye të ndryshme, profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, edhe pse ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes së gradave/titujve shkencorë.</p>	27-28	I MESËM	<p>MASR, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ose të shikojë mundësinë e krijimit të strukturës për njohjen së gradave shkencore brenda MASR-së, ose transferimin e këtij shërbimi pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Nëse dakortësohet që kjo strukturë të qëndrojë si pjesë e MASR, nevojitet që të përcaktohen qartë detyrat funksionale të sekretariatit teknik dhe komisioneve ad hoc, në mënyrë që të përmirësohet detyrimi i MASR, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim, si dhe në përmbushje të kërkesave të qytetarëve.</p>
5	<p>Për njohjen/njësimin e gradës shkencore, strukturat jopermanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, në asnjë referencë ligjore/nënligjore, nuk kërkohet të merret konfirmim zyrtar pranë Ministrisë së Arsimit, të shtetit të huaj. Në përgjithësi, MASR ka mbajtur standardin e mësipërm, ndërsa, për njohjen/njësimin e gradës shkencore të tre rasteve, të aplikuar në korrik 2017, të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës (UNS) në Maqedoninë e Veriut, në vitet 2016 dhe 2017, nga ana e sekretariatit teknik dhe komisionit ad hoc, janë mbajtur dy standarde, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sekretariati teknik, ka përdorur <u>formën e komunikimit me email</u>, në mbështetje të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1, duke i kërkuar informacion për vlerësim objektiv për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore, pranë UNS, më datë 07.09.2017 dhe më datë 21.05.2020. Në të dy rastet, është kthyer përgjigje miratuese si nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës si dhe në rastin e dytë është marrë edhe një përgjigje me email nga Drejtoria e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit e Shkencës në Maqedoninë e Veriut, e cila në këtë rast</li></ul>	28-31	I LARTË	<p>Nga ana e MASR, të merren masa për zgjidhje të menjëhershme, të realizimit të vendimmarrjes, pasi janë kaluar ekstremishtë afatet (deri tani ka marrë 3 vjet), duke cenuar mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë.</p>



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

<p>shërben dhe si qendra e rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC-NARIC) mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>-Komisionet ad hoc, të ngritur, me urdhrin e Ministrit të MASR nr.644, datë 15.12.2017 dhe me urdhrin nr.151 datë 01.06.2020 me objekt “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, në procesverbalet respektivë me nr.1 datë 19.02.2018 dhe nr. 2 të datës 12.06.2020, shprehen se përgjigjet me email konsiderohen të pamjaftueshme për të dalë në një vendim përfundimtar negativ apo pozitiv (konfirmuar ky fakt me shkresën nr.3013/1 prot datë 13.07.2020 të MARS) dhe për rrjedhojë kanë vendosur të kërkojnë zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut, lidhur me vlefshmërinë e disa diplomave të studimit të ciklit të tretë, për rastet e sipërpërmendur.</p> <p>Vlen të theksohet se nga MASR, deri në momentin e hartimit të materialit të auditimit, grupit nuk ju vunë në dispozicion praktikat zyrtare të dërguara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut, por i është vënë praktika me shkresë nr.3072 prot datë 28.02.2019 që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Shqiptare), ka përcjellë materialin e zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme e Maqedonisë së Veriut dhe jo nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Shkencës së Maqedonisë së Veriut. Kjo formë komunikimi nuk është e përcaktuar në Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1. Gjithashtu, në procesverbalet, nuk është dhënë asnjë arsytim, pse duhej të kërkohej zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut apo të merrej informacion pranë zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, ndryshe nga praktikat e njohjes me vendet e ndryshme të huaja, duke vënë në dyshim vërtetësinë e marrjes së gradës shkencore si dhe a ka të drejtë Komisioni ad hoc, të shikojë legjislacionin e huaj apo të mbështetet në detyrimin ligjor që ka Ministria e Arsimit në Republikën e Shqipërisë, sipas Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, pasi në praktikat e audituara për aplikantë të ndryshëm të cilët që kanë studiuar në vende të ndryshme të huaja për nivelin e 8, nuk është ndjekur kjo formë komunikimi, por vetëm me email pranë universiteteve apo</p>			
--	--	--	--



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

<p>pranë qendrës (ENIC-NARIC).</p> <p>-Gjithashtu, nga auditimi, duke krahasuar një praktikë tjetër të ngjashme, me praktikën e tre rasteve të konstatuara më lartë për njohje, ku studimet janë kryer në të njëjtin universitet, komisioni ad hoc i ngritur me Urdhrin nr.106 datë 25.02.2019 “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, i ka njohur/njësuar gradën “doktor”, në mungesë të shkresës zyrtare nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, duke u bazuar në informacionin e dhënë nga Ministria e Jashtme e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar.</p>			
---	--	--	--

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Nga auditimi i zhvilluar mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit, u evidentua se:

1.Udhëzimet e miratuara nga titullari i MASR, janë hartuar jo në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke mbartur riskun e cenimit të kontroleve të brendshme që në fazën e hartimit të tyre, risqe këto të cilat më pas mbarten edhe në fazën e implementimit, duke mos i shërbyer funksionimit efektiv për të cilin janë hartuar.

-Janë krijuar struktura për njësimin e certifikave, diplomave, gradave shkencore, pa siguruar detyra funksionale juridike, deri diku të mbivendosura, në kundërshtim me ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9, 10 dhe 92; ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6; ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20; VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”; dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.”.

-QSHA, funksionon me një Rregullore të brendshme nr.1462 prot datë 02.09.2014, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, e cila nuk reflekton ndryshimet e strukturës sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”. Edhe pse QSHA me shkresën nr. 580 prot datë 30.01.2019, ajo ka dërguar për miratim në MASR, Draft- Rregulloren e Brendshme, ajo ende nuk është miratuar nga titullari i MASR, në kundërshtim kjo me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20.

-Në referim të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, (institucione varësie), është e drejta e Këshillit të Ministrave, për krijimin dhe mbylljen e strukturave të varësisë, dhe jo Ministri i Arsimit, për rrjedhojë, edhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr. 8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, është në kundërshtim referencën ligjore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

2. Nga auditimi i zhvilluar mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Ministrisë së Arsimit, Sportit në lidhje mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave të shërbimeve në buxhetin e shtetit, u evidentua se:

- Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk ekziston, për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik, ku anëtarë janë specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë dhe këtë detyrim shtesë, për të cilin as nuk vlerësohen nga eprori direkt, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 62 ku parashikohet se, komisionet ad hoc dhe sekretariati teknik, ngrihen kohë mbas kohë, me urdhër të titullarit të MASR, pra këto “struktura” nuk janë permanente.

- Ka munguar një kuadër rregullator i mirëfilltë mbi të cilin të kryhet vlerësimi i titujve shkencorë, i cili deri më tani është kryer me komisione ad hoc; ka munguar një kriter mbi afatet/kohën e procedurave që ndjek komisioni ad hoc për shqyrtimin e dokumentacionit deri në vendimmarrje, që ka sjellë tejzgjatje të procedurave deri në disa muaj.

- Për njohjen/njësimin e gradës shkencore, strukturat jo permanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, të cilat miratohen kohë mbas kohe me Urdhër të ministrit të Arsimit, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92 dhe të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, kanë fillimisht detyrimin, që nëpërmjet komunikimeve me e-mail pranë universiteteve të huaja, të marrin konfirmim mbi vlefshmërinë e diplomës për përfundimin e ciklit të tretë të studimeve (të aplikantit) si dhe mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, pranë qendrës së rrjetit evropian të informimit (ENIC-NARIC) të shtetit të huaj. Nga auditimi rezultoi se, në asnjë referencë ligjore/nënligjore, nuk kërkohet të merret konfirmim zyrtar pranë Ministrisë së Arsimit, të shtetit të huaj. Në përgjithësi, MASR ka mbajtur standardin e mësipërm, ndërsa, për njohjen/njësimin e gradës shkencore të aplikantëve (G B, F Gj dhe S D, aplikuar në korrik 2017) të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës (UNS) në Maqedoninë e Veriut, në vitet 2016 & 2017, nga ana e sekretariatit teknik dhe komisionit Ad hoc, kanë mbajtur dy standarde.

## OPINIONI I AUDITIMIT

### ***Opinion i pamodifikuar me “siguri të kufizuar”,***

Në bazë të punës së kryer, grupi auditoi përputhshmërinë, mbi ndryshimet e Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë MASR dhe njësia e varësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të përshkruar në këtë Raport përfundimtar, ku asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara.

### ***Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë***

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2008. Auditimi ynë përfshin, procedurat mbi njohjen e diplomave, titujve apo gradave shkencore të fituara jashtë vendit, në bazë të evidencave të mjaftueshme të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur, mbështetur mbi gjykimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendim marrjes nga MASR, me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm për dhënien e **opinionit të pamodifikuar me siguri të kufizuar**<sup>1</sup>

### Paragrafi i Theksimit të Çështjes

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se udhëzimet e miratuara nga titullari i MASR, janë hartuar jo në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke mbartur riskun e cënimit të sistemeve të kontroleve të brendshme, që në fazën e hartimit të tyre, si dhe në fazën e implementimit, duke mos i shërbyer funksionimit efektiv për të cilin janë hartuar. Grupi i auditimit konstatoi se:

- janë krijuar struktura për njësimin e certifikatave, diplomave e gradave shkencore, pa siguruar detyra funksionale juridike, deri diku të mbivendosura, në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9, 10 dhe 92; ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20; VKM nr. 560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”; dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.”.

- ka munguar një kuadër rregullator i mirëfilltë mbi të cilin të kryhet vlerësimi i titujve shkencorë, i cili deri më tani është kryer me komisione ad hoc; ka munguar një kriter mbi afatet/kohën e procedurave që ndjek komisioni ad hoc për shqyrtimin e dokumentacionit deri në vendimmarrje, që ka sjellë tejzgjatje të procedurave deri në disa muaj.

- Udhëzimi nr.17, datë 03.08.2016, i ndryshuar, parashikon njohjen e diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, edhe pa vulë apostile duke zbehur efikasitetin e sistemeve të kontrollit, të cilat mund të sjellin abuzime.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe njësisë së varësisë së saj të QSHA, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

1.Nëse audiuesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë *siguri të kufizuar*, si dhe në bazë të punës së kryer, asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara, gjithashtu, audituesi shton një paragraf të theksimit të çështjes.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

### **I. Hyrja.**

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.810/1, datë 01.09.2020 në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Tiranë, nga data 01.09.2020 – 15.10.2020, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.08.2020, u krye auditimi i Përputhshmërisë në MASR, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. V. G (përgjegjës grupi),
2. E. M, anëtar
3. M. Ll, anëtar

#### **1) Titulli:**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)

#### **2) Marrësi:**

Ky Raport i adresohet Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Znj.E.K.

### **METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT**

#### **3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

**Objektivat specifike të auditimit** dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit.

**Qëllimi i auditimit** është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë.

#### **4) Identifikimi i çështjes:**

Organizimi dhe funksionimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MARS), në lidhje me objektin e auditimit mbi procedurat dhe kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit”, rregullohet në bazë të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. MASR, është institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave Njesisë së njohjes së diplomave dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) si dhe Komisioneve ad hoc që ngrihen me urdhër të Ministrit të MASR për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore, të fituar jashtë vendit.

Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlerëshëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokument, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.810/1, datë 01.09.2020.

#### **5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

MASR, është institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave Njësisë së njohjes së diplomave dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) si dhe Komisioneve ad hoc që ngrihen me urdhër të Ministrit të MASR për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore, të fituar jashtë vendit.

#### **6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe njësisë së varësisë së saj të QSHA, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

#### **7) Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji Organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr.8834, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë”.
- Ligji nr.10247, datë04.03.2010 “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.
- VKM nr.371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”.
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me Vendimin nr. 85, datë 30.06.2015, e ndryshuar me Vendimin nr.257, datë 31.12.2018 të Kryetarit të KLSH-së.
- Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me Vendimin nr.63 datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”.
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.32, datë 29.12.2017 “Disa ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë,



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.15, datë 16.04.2018 “Për shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.5, datë 21.02.2019 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.30, datë 30.12.2019 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit” i ndryshuar.

#### **8)Standardet e Auditimit**

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI).

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC.

-ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë.

-ISSAI 400-499 Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë.

- “Libri Jeshil” i GAO-s, etj;

#### **9)Medodat e auditimit**

Në bazë të auditimit, mbi ndryshimet e Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë MASR dhe njësia e varësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) si dhe duke u bazuar në evidencave të mjaftueshme mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, për të parë funksionimin e riskut të cënimit të sistemeve të kontroleve të brendshme, që në fazën e hartimit të tyre, si dhe në fazën e implementimit.

Procedurat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore me bazë numrin e aplikimeve dhe dosjet respektive, të grupeve të interesit për vitet objekt auditimi, duke u përqëndruar në vendimarrjen nga MARS dhe në QSHA, për njësimin e diplomës/ certifikatë, gradave shkencore dhe titujve, për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi.

#### **10)Dokumentimi i auditimit**

Auditimi i përputhshmërisë, është realizuar në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e (SAI) si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 , e ndryshuar me Vendimin nr.63 datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së MARS-së, me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje mbi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit, u fokusua, në zbatimin, e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr.8834, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë”; të ligjit nr.10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”; të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të VKM-së nr.1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017; të VKM-së nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga qendra e shërbimeve arsimor”; të Urdhërit të Kryemistrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”; të Urdhërit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”; të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar me (udhëzimin nr.32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019); të Udhëzimit i Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, etj.

## II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. Informacioni i përgjithshëm

Organizimi dhe funksionimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MARS), në lidhje me objektivat e auditimit, rregullohet në bazë të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar me (udhëzimin nr.32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019), të Udhëzimit i Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, si dhe disa ligje/ akte nënligjore, të cilat kanë si qëllim rregullimin juridik, në lidhje mbi objektin e auditimit.

MARS, është institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave njësisë së njohjes së certifikatave/diplomave/gradave/titujve shkencorë të fituar jashtë vendit, (sekretariati, komisione ad hoc, të cilat ngrihen kohë pas kohe me urdhër të titullarit (Ministri) i MARS) dhe njësisë së varësisë, Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlerëshëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikate, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokument, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Për sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit në mbështetje të të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, realizon këtë auditimin, për të parë përputhshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi procedurat e njohjes së certifikatave/diplomave/gradave/titujve shkencorë të fituara jashtë vendit, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptar.

### 2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit.

- Qëllimi i auditimit: Vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptar.

Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të MASR me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2018-31.08.2020, si dhe janë audituar me përzgjedhje dosjet sipas programit për periudhën objekt auditimi.

### 2.1. MBI VERIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E KOMPETENCAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE, NË LIDHJE MBI PROCEDURAT DHE KRITERET E NDJEKURA PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN E CERTIFIKATAVE, DIPLOMAVE, TË FITUARA JASHTË VENDIT SI DHE ARKËTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË BUXHETIN E SHTETIT

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së MARS-së, me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit si dhe arkëtimi i tarifave për këto shërbime, në buxhetin e shtetit, u fokusua, në zbatimin, e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr.8834, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë”; të ligjit nr.10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”; të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të VKM-së nr.1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017; të VKM-së nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”; të Urdhërit të Kryemistrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”; të Urdhërit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”; të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar me (udhëzimin nr.32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019); të Udhëzimit i Ministrit të Arsimit nr.8



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, etj.

Nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatua:

-Në bazë të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë” neni 92 (Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë) citohet se:

*1-“Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të baravleshëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.*

*2-Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga insticioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standarteve ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.*

*3-Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore, është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave.*

*4-Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.*

*5-Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikë lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse.*

*6-Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar sipas fushës së punësimin.*

*7-Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë.”*

- Titullari i MARS (Ministri) ka miratuar Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar me (udhëzimin nr.32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019).

-Titullari i MARS (Ministri) ka miratuar Udhëzimin e Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.

Nisur sa më sipër, grupi i auditimit, vlerësoi përputhshmërinë e akteve të miratuara nga titullari i MARS, në bazë të dokumentacioneve administrative/praktikat e brendshme (Memo/relicion), si pikënisje e ndryshimeve të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar me (udhëzimin nr.32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019) si dhe vlerësoi nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë MARS dhe njësia e varësisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), në mënyrë për të bërë të mundur



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, me synimin në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptar dhe të huaj.

Më poshtë po paraqesim, ndryshimet dhe konstatimet në lidhje me përputhshmërinë;

**1). Udhëzimi nr.32 datë 29.12.2017** “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshim, duke kërkuar “fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetas të huaj).”

Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatua se, në praktikën e sjellë, nuk është paraqitur dokumenti administrativ (Memo/Relacion) në lidhje mbi arsyet e ndryshimit.

**2). Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018**, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshim si vijon:

- Në Kreun II, duke i dhënë të drejtën QSHA të realizojë procedurën për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të fituara jashtë vendit;

- Në pikën 1 të Kreut IV për aplikimin të postës elektronike, ku nëse vihet re mangësi nga momenti i depozitimit të aplikimit në QSHA, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit i kërkohet plotësim, në rast se nuk plotësohet, brenda 4 javëve dosja depozitohet në QSHA, duke mos e vazhduar procedurën për njësim dhe njohje;

- Në pikën 5.2 të Kreut IV, shtohet : diplomat e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri;

- Në Kreun VII, aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim komisionit të njohjes së diplomave (KNJD) brenda 30 ditëve, duke përjashtuar njohjen e gradës shkencore “doktor” dhe titujve akademikë për të cilin i drejtohet Komisionit ad- hoc përkatës.

Dokumentet administrative (Memo/Relacion) në lidhje mbi arsyet e ndryshimit, nuk iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, ndonëse është kërkuar si me kërkesave formale dhe me kërkesë zyrtare më datë 30.09.2020, nr. 4565/2 prot e MARS (drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm). Audituesve iu është dhënë vetëm Udhëzimi i firmosur me elementët, konc. G. B dhe I. S, pranoi nga E. Idhe E. T dhe miratuar nga K.B.

Nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatua se:

**a)** Dhënia e detyrimit funksional, që Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) të realizojë procedurën për njohjen dhe njësimin, diplomave, certifikatave, të fituara jashtë vendit, nëpërmjet Udhëzimit nr.15 datë 16.04.2018, miratuar nga Titullari i MARS (Ministri), ka humbur shkallën hierarkike juridike, pasi QSHA, vazhdon të operojë dhe të funksionojë në bazë të VKM nr.1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, me detyra funksionale, sipas pikës 3 ku shprehet se:

“QSHA, merret me organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksionin teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës të shtetit”.

“QSHA

a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

- b) Kryen dhe administrojnë vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionin për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor para universitar.
- c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.
- ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.
- d) Organizon dhe administrojnë Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.
- dh) Krijon bazën shtetërore të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.
- e) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.
- ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.
- f) Publikon on-line programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.
- g) Administrojnë bazën e të dhënave për arsimin para universitar.
- gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administrojnë bazën elektronike të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.
- h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj.
- Pra, në asnjë pikë të VKM-së nr.351 datë 26.04.2017, në cilësimin e detyrave funksionale, QSHA nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.**

**b)** Nga auditimi u konstatua se, si nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, nuk është ndërmarrë veprimi juridik për ndryshimin e VKM së mësipërme, për të marrë atributin e këtij shërbimit, ndonëse nga Kryeministri me Urdhër nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore” si dhe VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, veprim në përputhje me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6 (institucionet e varësisë) ku thuhet se :

1. Institucionet e varësisë mund të krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim, dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën apo shërbime të brendshme për administratën shtetërore ose mbështetje e këshillim për ministrinë.

2. Përveçse kur parashikohen drejtpërdrejtë nga ligji, institucionet e varësisë krijohen dhe mbyllen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës apo përkatësisht Kryeministrit dhe kanë personalitet juridik publikë.

**c)** Duke iu referuar ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 8 ku shprehet se:

1. Njësitë e drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve janë struktura administrative, nëpërmjet të cilave një ministri apo institucion i varësisë kryen shërbime publike drejtpërdrejt për të tretët, në fushat e parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësitë e drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve krijohen dhe mbyllen me urdhër të ministrit përgjegjës përkatës, në përputhje me legjisllacionin e posaçëm dhe pas konsultimit publik me përfaqësuesit e përfituesve të mundshëm të shërbimit, me qytetarët e interesuar, me njësitë vendore dhe me aktorë të tjerë të interesuar.

3. Veprimtaria e njësive të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve drejtohet dhe bashkërendohet drejt



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

*përdrejt nga ministria/institucioni i varësisë apo nëpërmjet degëve të tyre përkatëse territoriale.”*

Për sa më sipër, grupi i auditimit, konstaton se edhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore” pika 10 ku thuhet se “Struktura dhe organika e QSHA-së përcaktohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë e Financave”, bie në kundërshtim me VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, pasi kjo njësi varësie e MARS është krijuar dhe operon me VKM (pavarësisht se njësimi i diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit, nuk është parashikuar) dhe me Urdhrin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.” (Është shtuar sektori i njohjes së diplomave të Arsimit të Lartë).

**d)** Gjithashtu, nga auditimi i funksionimit të QSHA u konstatua se, nuk është bërë miratimi i Rregullores së funksionimit të QSHA, me ndryshimin e strukturës dhe organikës, ndonëse nga QSHA me shkresë nr.580 prot datë 30.01.2019 është dërguar për miratimin Rregullorja e funksionimit të QSHA, në MARS, pasi detyrimin ligjor për miratimin e saj e ka titullari i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20 dhe me Urdhrin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.”

Qendra e Shërbimeve Arsimore, funksionon me Rregullore të brendshme e Agjencisë Kombëtare të provimeve me nr.1462 prot datë 02.09.2014, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

e) Sipas ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 29 (Procedura e delegimit) pika 2/d thuhet se “*Kur ligji e lejon, delegimin e kompetencave bëhet në çdo rast me vendim të organit delegues për organet në varësi të tij.. Në aktin e delegimit përcaktohet ...data e fillimit të ushtrimit të kompetencave të delegimit.*”

Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatua se, Udhëzimi nr.17, i ndryshuar, nuk e ka në përmbajtje, datën e fillimit të ushtrimit të kompetencave në QSHA, por në Kreun VIII (Dispozita të fundit) pika 2 thuhet “*...Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare*”.

Nga auditimi rezultoi se është botuar në Fletoren Zyrtare nr.59/2018, më datë 26.04.2018, ndërsa procesi i njësimi të diplomave është transferuar në QSHA nga MARS, në muajin shtator 2018.

f) Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i Njohjes së Diplomave, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk ekziston. Për rrjedhojë këtë detyrë e ka realizuar sekretariati teknik, i cili është ngritur kohë mbas kohe, me urdhër të Ministrit të MARS, deri në momentin e miratimit të Udhëzimit nr.15 datë 16.04.2018, deri në momentin e ofrimit të shërbimit nga QSHA (shtator 2018), duke sjellë “mbivendosje të strukturave”.

**Për më sipër,** konstatimet e mësipërme tregojnë se, miratimi i Udhëzimit nr.15 datë 16.04.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, ka elementë juridikë të pasaktë dhe jo në mbështetje të bazës ligjore/ nënligjore, e për pasojë kemi struktura (komisione) të cilat funksionojnë juridikisht me “rregulla”, në mospërputhje me ligjet, apo procedura, mbi të cilat është rënë dakord.

**3).** Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

*diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit*”, i ndryshuar ka pësuar ndryshim si vijon:

-Në Kreun IV pika 5.4, Kryetar i komisionit është zëvendësministri që mbulon çështjet e arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse, në Udhëzimin nr.17, këtë rol e kryente Ministri i Arsimit.

Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatua se, dokumenti administrativ (Memo/Relacion) arsyet e ndryshimit, janë dy Memo, të cilat nuk flasin për ndryshimin por për ngritjen e komisionit ad hoc të radhës për njësimin gradave shkencore. Audituesve iu është dhënë vetëm Udhëzimi i firmosur me elementët, konc. V. B, pranoi. E. T dhe miratoi. O. M.

**4).**Udhëzimi nr.30, datë 30.12.2019 “*Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit*” i ndryshuar, ka pësuar ndryshim:

-Të gjitha aplikimet për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit të 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë kryhen vetëm online nëpërmjet portalit e-albania, ndërsa në rrugë postare (format hard –copy) pas kryerjes së aplikimit on-line, paraqitet një kopje e diplomës/certifikatës dhe suplementit (nëse ka të tillë), të njësuar me origjinalin, si të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës, si dhe në format hard-copy pas aplikimit on-line, paraqitet një kopje e dokumentit të fitimit të titullit akademik, të njësuar me origjinalin, në përputhshmëri me kërkesën e sipërcituar për diplomat/certifikatat, etj.

Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatua se, dokumenti administrativ (Memo/Relacion) arsyet e ndryshimit, është Memo 26.12.2019, e miratuar nga E. T Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë për Arsimin , Sportin dhe Rininë dhe Z. G Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ku midis të tjerave argumentohet se “*..Në vijim të urdhrimit të kryeministrit nr.153 datë 25.11.2019 dhe urdhrimit tuaj nr.583 datë 13.12.2019 në kuadër të ofrimit të shërbimeve online, në bashkëpunim me drejtorinë Juridike kemi përgatitur draft-udhëzimin me ndryshimet përkatëse në udhëzimin e njohjes së diplomave, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit të njohjes së diplomave dhe gradave shkencore përmes aplikimit online dhe duke dorëzuar dokumentet hard copy.*”

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, aplikimi i shërbimit on-line, ka bërë të mundur “mbylljen e shtegut” të mosplotësimit të formularit të aplikimit në web -site të MARS, ku është konstatuar se gjatë vitit 2018 deri në momentin e transferimit në QSHA shtator 2018,ka pasur mjaft raste me aplikim të paplotësuar, kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”, si dhe duke hedhur dritë hije mbi njësimin e diplomave (në disa raste aplikantët as emrin e tyre nuk e vendosnin në rubrikën e duhur, duke vënë në dyshin nivelin e tyre arsimor, profesional dhe akademik).

Në lidhje mbi këto konstatimi u mbajt Akt konstatimi nr.1 datë 15.10. 2020 me nr.4563/3 prot datë të MASR dhe Akt konstatimi nr.3 datë 15.10.2020, i cili u mbajt me Qendrën e Shërbimeve Arsimore me nr.3724 prot datë 15.10.2020, të cilët kanë observuar MASR me shkresë nr.4563/7 prot, datë 23.10.2020 dhe QSHA me shkresë nr.3724/2 prot , datë 16.10.2020 si dhe observimet e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MASR, në lidhje mbi Projekt Raportit përcjellë nga KLSH me shkresë nr.810/2 prot datë 19.11.2020, dërguar me shkresë të MASR nr.4563/9 datë 24.12.2020.

**Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.**

### **Pretendimi i subjektit:**

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është institucion publik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimin e aksesit publik në të dhënat për arsimin e lartë, bazuar në nenin 9 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku një ndër funksionet e dhëna me ligj është dhe funksioni i dhënë sipas germës “d” të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji “d) ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.”.

Në zbatim të këtij ligji është bërë organizimi dhe funksionimi i QSHA, fillimisht nëpërmjet udhëzimit të Ministrit të MASR nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, në zbatim të pikës 4 të nenit 9 të ligjit 80/2015 dhe nenit 8 të ligjit nr.90/2012, në të cilët përcaktohet se:

Pika 4, neni 8 i ligjit 80/2015:

*“4. Organizimi, funksionimi i QSHA-së dhe procedurat e regjistrimit të studentëve rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”*

Pika 2, neni 8, i ligjit 90/2012:

*“2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve krijohen dhe mbyllet me urdhër të ministrit përgjegjës përkatës, në përputhje me legjislacionin e posaçëm dhe pas konsultimit publik me përfaqësuesit e përfutuesve të mundshëm të shërbimit, me qytetarët e interesuar, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me aktorë të tjerë të interesit.”*

Në mbështetje të bazës ligjore të mësipërme, në germën “c” të pikës 4 të udhëzimit nr.8, datë 13.03.2017, Ministri përgjegjës për arsimin i ka deleguar kompetencën e konstatuar si të papërputhshme nga ana juaj, si më poshtë:

*c) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për njohjen e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.*

Nëpërmjet VKM-së nr.351, datë 26.04.2017, janë unifikuar dy institucionet e organizuara si më sipër, ish-Agjencisë Kombëtare e Provimeve dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore në institucionin e vetëm Qendra e Shërbimeve Arsimore, e cila ushtron funksione në:

Fushën e arsimit parauniversitar në bazë të ligjit nr.69/2012 i ndryshuar, VKM-së nr. 1013, datë 10.12.2010 e ndryshuar me VKM nr. 351, datë 26.04.2017;

Fushën e Arsimit të lartë në bazë të ligjit 80/2015 dhe udhëzimit të Ministrit nr.8, datë 13.03.2017.

Për sa më sipër, konstatimi “a” faqe 4, e Akt konstatimit nr.1, duhet rishikuar nga ana juaj, pasi detyrimi juridik funksional është plotësuar nëpërmjet përcaktimeve të mësipërme ligjore dhe nënligjore.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1.Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore” pika 10 ku thuhet se “Struktura dhe organika e QSHA-së përcaktohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë e Financave”, bie në kundërshtim me VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, pasi kjo njësi varësie e MARS është krijuar dhe operon me VKM (pavarësisht se njësimi i diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit, nuk është parashikuar) dhe me Urdhër të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.” (Është shtuar sektori i njohjes së diplomave të Arsimit të Lartë), veprim në përputhje me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6 (institucionet e varësie).

2. Në asnjë pikë të VKM-së nr.351 datë 26.04.2017, në cilësimin e detyrave funksionale, QSHA nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit si dhe si nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, nuk është ndërmarrë veprimi juridik për ndryshimin e VKM së mësipërme, për të marrë atributin e këtij shërbimit, ndonëse nga Kryeministri me Urdhër nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.

Gjithashtu, nga auditimi i funksionimit të QSHA u konstatua se, nuk është bërë miratimi i Rregullores së funksionimit të QSHA, me ndryshimin e strukturës dhe organikës, ndonëse nga QSHA me shkresë nr.580 prot datë 30.01.2019 është dërguar për miratimin Rregullorja e funksionimit të QSHA, në MARS, pasi detyrimin ligjor për miratimin e saj e ka titullari i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20 dhe me Urdhër të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore.”

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me pikën nr. 2.2.2 të Projekt Raportit “**Auditimi mbi njohjen e certifikatave/diplomave të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, të njësuar nga MARS për periudhën janar 2018 – deri në shtator 2018**”, kemi sqaruar në mënyrë të detajuar në pikën 7 të observacioneve mbi aktkonstatimit nr. 2 të grupit të KLSH se përse nuk ka pasur asnjë mbivendosje të strukturave. Më poshtë gjeni argumentimin se përse konstatimi mbi “mbivendosjen e strukturave” nuk qëndron:

“Në mungesë të Sektorit të Njohjes së Diplomave, Sekretariati Teknik është krijuar dhe e ka ushtruar detyrën në zbatim të urdhrimit të ministrit nr. 663, datë 28.12.2017, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet përbërja e Komisionit të Njohjes së Diplomave, si dhe e Sekretariatit Teknik, deri në ngritjen e Sekretariatit Teknik në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Nuk rezulton të ketë pasur mbivendosje të strukturave as për sa i përket Komisionit të Njohjes së Diplomave e as për sa i përket Sekretariatit Teknik. Komisioni i Njohjes së Diplomave është ngritur në QSHA (me nëpunës të QSHA) me anë të urdhrimit të ministrit nr. 479 datë 27.07.2018. Vetëm pas miratimit të këtij urdhri (27.07.2018) ka filluar punën Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA dhe jo në shtator 2018. Komisioni i Njohjes së Diplomave i ngritur në MASR nuk ka nënshkruar e lëshuar asnjë vërtetim njohjeje dhe njësimi pas miratimit të Urdhrit të ministrit nr. 479 datë 27.07.2018, gjë që provon mungesën e mbivendosjes të dy Komisioneve të Njohjes së Diplomave.

Gjithashtu, udhëzimi nr. 15, datë 16.04.2018 nuk rezulton të përjashtojë përfshirjen e nëpunësve të MASR në Komisionin e Njohjes së Diplomave apo në Sekretariatin Teknik. Saktësojmë se në periudhën pas miratimit të udhëzimit nr.15, datë 16.04.2018 dhe deri më 27.07.2018, Sekretariati Teknik ka qenë i përbërë nga anëtarë të MASR dhe QSHA. Në kushtet kur struktura e QSHA nuk e ka përfshirë Sektorin e Njohjes së Diplomave deri pas miratimit të strukturës përkatëse me Urdhrit të Kryeministrit nr. 146, datë 28.09.2018, përfshirja e 3 nëpunësve të QSHA në Sekretariatit Teknik ka qenë zgjidhja më optimale për fillimin e angazhimit të QSHA në procedurat e njohjes dhe njësimi. Përfshirja edhe e nëpunësve të MASR në Sekretariatin Teknik, krahas nëpunësve të QSHA-së, është realizuar në mënyrë që t'i jepet ndihma e nevojshme nëpunësve të QSHA-së në hapat e para, si dhe në kushtet kur një pjesë e aplikimeve të njohjes ishin ndjekur nga nëpunësit e MASR. Synim kryesor në gjithë procedurat e ndjekura ka qenë mundësimi i vijimësisë sa më natyrale të procedurave të njohjes dhe ruajtja e cilësisë në ofrimin e shërbimit ku një komponent i rëndësishëm është respektimi i afateve të përcaktuara në udhëzimin përkatës. Për procedurat e njohjes dhe njësimi të realizuara në këtë periudhë nuk rezulton të ketë pasur ankesa nga qytetarët të cilët kanë aplikuar për njohjen dhe njësimin e diplomave.

Po ashtu, në 18 diplomat që KLSH ka konstatuar se janë njohur në periudhën e “mbivendosjes” nuk rezulton të jetë konstatuar asnjë parregullsi në dokumentacion apo në procedurat e njohjes. Gjithashtu, vendimi më i fundit nga Komisioni i Njohjes së Diplomave me nëpunës të MASR rezulton të jetë me datë 26.07.2018 gjë që provon mungesën e mbivendosjes pasi nga data 27.07.2018 fillon funksionimin Komisioni i Njohjes së Diplomave me nëpunës të QSHA, i ngritur me urdhrin e ministrit nr. 479 datë 27.07.2018”.

### **-Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1. Udhëzimi nr. 17, i ndryshuar, nuk e ka në përmbajtje, datën e fillimit të ushtrimit të kompetencave në QSHA, por në Kreun VIII (Dispozita të fundit) pika 2 thuhet “...Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare”.

Nga auditimi rezultoi se është botuar në Fletoren Zyrtare nr.59/2018, më datë 26.04.2018, ndërsa procesi i njësimi të diplomave është transferuar në QSHA nga MARS, në muajin shtator 2018.

2. Gjithashtu, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk ekziston, për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik i ngritur me urdhër të herëpashershëm nga titullari i MASR, me specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë detyra shtesë, për të cilat as nuk vlerësohen nga eprori direkt, duke e quajtur si një detyrë “honorific” dhe si një punë vullnetare, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil.”

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

**Grupi i auditimit, gjatë procesit të auditimit pranë QSHA**, përzgjedhi në mënyrë rastësore me bazë numri aplikimet dhe dosjet e grupeve të interesit për vitet objekt auditimi, duke u përqëndruar në vendimmarrjen nga QSHA, për njësimin e diplomës/ certifikatës etj.

Kështu, për periudhën shtator 2018-dhjetor 2018 në QSHA janë depozituar 485 aplikime ndër të cilat janë marrë 459 vendime për njësimin e diplomave , 21 vendime për mosnjohje diplomash dhe 5 procedura janë në proces si pasojë e mungesës së informacionit që nuk varen nga QSHA.

Për vitin 2019 në QSHA janë depozituar 861 aplikime ndër të cilat janë marrë 789 vendime për njësimin e diplomave , 33 vendime për mosnjohje diplomash dhe 39 procedura janë në proces si pasojë e mungesës së informacionit që nuk varen nga QSHA.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

*Për periudhën janar 2020-gusht 2020* në QSHA janë depozituar 399 aplikime ndër të cilat janë marrë 234 vendime për njësimin e diplomave , 11 vendime për mosnjohje diplomash dhe 154 procedura janë në proces si pasojë e mungesës së informacionit që nuk varen nga QSHA.

*Në mënyrë të përmbledhur vihen re problematikat e mëposhtme:*

- Dosjet e procedurave të njësimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
- Në disa procedura të njësimin vihet re se vendimet e njësimin janë të parregullta pasi janë të pa protokolluara dhe pa datë përkatësisht:

1-Vërtetimi i njohjes së znj.B. M lëshuar nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedoni më datë 28.06.2017, me kohëzgjatje 3 vjeçare, 180 kredite në Shkenca Juridike, me drejtim Kriminalistikë dhe Detektiv. Kjo diplomë njësohet si Bachelor ne Republikën e Shqipërisë. Komisioni i njohjes së diplomave (KNJD) me përbërje: A. A, A. M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

2- Vërtetimi i diplomës së z.A. A, lëshuar nga Universiteti i Katantias, Itali, më datë 21.07.1983, me kohëzgjatje 5 vjeçare në Kirurgji. Kjo diplomë njësohet si specializim afatgjatë, në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A. M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

3-Njohjen e diplomës së znj.A.Th , lëshuar nga Universiteti i Egjeut, Greqi më datë 30.07.2015, me kohëzgjatje 4 vjeçare, 243 ECTS, në Shkenca e Edukimit Parashkollor dhe Projektimit Arsimor. Kjo diplomë njësohet si Bachelor, në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

4-Njohjen e diplomës së znj.A.S, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Kosovë, më datë 30.09.2009, me kohëzgjatje 3 vjeçare në Psikologji. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

5-Njohjen e diplomës së znj. A. M, lëshuar nga Universiteti i Bolonjës, Itali, më datë 30.01.208 me kohëzgjatje 1 vjeçare, 62 ECTS në Jurist Ndërkombëtar. Kjo diplomë njësohet si Master Profesional, në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

6-Njohjen e diplomës së Z. A. M, lëshuar nga Universiteti Ndërkombëtar I Strugës, Maqedoni, më datë 07.06.2018, me kohëzgjatje 2 vjeçare, 120ECT në Shkenca juridike. Kjo diplomë njësohet si Master i Shkencave, në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

7-Njohjen e diplomës z.A. H, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Kosovë, më datë 20.11.2006, me kohëzgjatje 4 vjeçare, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Kjo diplomë njësohet si Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

8-Njohjen e diplomës së znj.B. Z lëshuar nga Brigham Young University-Idaho, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më datë 11.04.2014, me kohëzgjatje 4-vjeçare, në mësimdhënie të Gjuhës Spanjolle. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. KNJD me përbërje: A. A, A.M dhe A.A, Sekretariati teknik me përbërje: M. B dhe A.S.

Në këtë procedurë konstatohet se si vendimi dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimin janë pa firmën e Drejtorit të Përgjithshëm znj.R. V.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Gjithashtu nga auditimi, u konstatua se, ndonëse QSHA e cila funksionon juridikisht me “rregulla”, në mospërputhje me ligjet, apo procedura, mbi të cilat është rënë dakord, përgjatë viteve 2019 dhe 2020, strukturat për njësimin dhe njohjen e certifikatave/diplomave janë në përmirësim të vazhdueshëm.

QSHA ka krijuar data-base kombëtar me të gjitha të dhënat për personat që kanë marrë njohje/njësime ose jo, por është për përdorim vetëm të brendshëm, për shkak të ruajtjes së privatësisë dhe kofidencialitetit të personit, ndërsa në faqen [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al) është publikuar vetëm lista me emrat e personave për njohje/ njësimit ose jo.

Nga auditimi në QSHA, të ardhurat e krijuara nga institucioni, në mbështetur në VKM nr.560, datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore” si më poshtë:

Tabela nr.1 (totali i të ardhurave të krijuara nga tarifatat për shërbimet e ofruara nga QSHA)

Periudha	Totali i të ardhurave të krijuara nga tarifatat e të gjitha shërbimeve (Bruto)/lekë	Të ardhura të krijuara nga shërbimi i njësimit të Diplomave të Arsimit të Lartë (NjDAL) (Bruto)/lekë	Përqindja e të ardhurave të krijuara nga shërbimi i NjDAL ndaj totalit të ardhurave (%)	Mbështetur në VKM nr.560, datë 29.09.2018, pika 4 e 5, të ardhurat e krijuara nga shërbimi i NjDAL janë shpenzuar	
				Paga 90%	Buxhet 10%
01janar -31 dhjetor 2019	99,585.55	1,720.00	1.73	1,548.00	172.00
01janar-31 gusht 2020	27,147.95	794.00	2.92	714.60	79.40

Ndërsa përse i përket, konstatimeve që grupi i auditimit ka bërë në lidhje mbi statusin juridik, funksionimin e QSHA sipas akteve nënligjore dhe Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, nuk është bërë asnjë koment.

Kështu në bazë të, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, pika “dh”, nëse punonjësit nuk paraqesin dokumente apo prova të reja dhe nuk kthejnë përgjigje problemet e trajtuara në aktkonstatim nr.3 do të konsiderohen të mirëqena.

### PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Titulli i Gjetjes 1:	<i>Ndryshime apo përmirësime ligjore (AktKonstatimi nr.1)</i>
Situata:	<p>-Sipas ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, sanksionon, njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara, nga studimet të kryera jashtë vendit që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, është detyrim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) si dhe <u>kriteret për njohjen dhe njësimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin</u>, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.</p> <p>-Sipas <u>ligjit nr. 80/2015</u> “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në nenet 9,10 QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.</p> <p>Në vijim u konstatua se, aktet administrative të miratuara nga Ministri i MASR, në funksion të ligjit të mësipërm, për çështjen objekt i këtij auditimi, paraqesin problematikat si më poshtë vijon:</p> <p>-Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, nr.17 datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar (i cili ka pësuar disa herë ndryshime të pjesshme, konkretisht me udhëzimet, nr. 32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019); si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit, nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore QSHA”, kanë bërë të mundur që, MASR të marrë me pa të drejtë kompetencën për transferimin e këtij detyrimi QSHA-së, në një kohë që këtë kompetencë e ka Këshilli i Ministrave. QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9 pika 4, por nga ana tjetër QSHA është krijuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, ku në asnjë pikë të kornizës ligjore, nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.

-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, sipas Kreut II, i ka njohur të drejtën QSHA-së, të realizojë procedurën vetëm për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të fituara jashtë vendit, ndërsa procedura për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, realizohet nga MASR, me anë të strukturave jo permanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, të cilat miratohen kohë mbas kohe me Urdhër të Ministrisë të Arsimit, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, pasi Sektori i Njohjes së Diplomave në MASR është suprimuar me Urdhër të Kryeministrit nr.163, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

- Udhëzimi nr.17 datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1 parashikon njohjen e diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, edhe pa vullë apostile, për verifikimin e autenticitetit të diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore. Mosekzistenca e këtij elementi, ul efikasitetin e sistemeve të kontrollit si dhe lë shteg për abuzime të ndryshme.

-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, i ndryshuar, nuk ka në përmbajtje, datën e fillimit të ushtrimit të kompetencave në QSHA, por shprehet se, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare, kreu VIII (Dispozita të fundit) pika 2. Nga auditimi u konstatua se, botimi është bërë më datë 26.04.2018 në fletoren zyrtare nr. 59/2018, ndërsa procesi i njësimit të diplomave është transferuar në QSHA nga MASR, në muajin shtator 2018, duke sjellë “mbivendosje të strukturave”, pasi deri në shtator 2018, këtë funksion e ka realizuar sekretariati teknik pranë MASR.

-Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar, numrin minimal të deponimeve të dosjeve të aplikimeve të gradave shkencore pranë “sekretariatit teknik” si dhe nuk ka të përcaktuar, afatet/kohën që i duhet komisionit ad hoc dhe sekretariatit teknik, për shqyrtimin e dokumentacionit, pasi konstatuam raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin, dhe vendim marrja për njohje/njësimit, është bërë mbas disa muajve.

-MASR dhe QSHA, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik, për të iniciuar hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, në përputhje me ndryshimet e mësipërme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim, me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenet, 9, 10 dhe 92, me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6 (institucione varësie), me VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga QSHA” dhe me Urdhër të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

<b>Kriteri:</b>	<p>-Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>-Udhëzimi nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar</p> <p>- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.</p> <p>- <u>Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018</u>, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”,</p> <p>- VKM nr.1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017</p> <p>- VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga qendra e shërbimeve arsimor”,</p> <p>-Ligji nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6.</p> <p>- Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</p> <p>- Urdhër i Kryeministrit nr.146, datë <u>28.09.2018</u> “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”,</p> <p>- Urdhri i Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Ligjshmëria dhe menaxhimi i veprimtarisë së MASR dhe njësisë së varësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptar dhe të huaj, pasi MASR të marrë me pa të drejtë kompetencën për transferimin e këtij detyrimi QSHA-së, në një kohë që këtë kompetencë e ka Këshilli i Ministrave
<b>Shkaku:</b>	Krijimi i udhëzimeve të cilat nuk janë në përputhshmëri me bazën ligjore mbi të cilat janë ngritur
<b>Rëndësia:</b>	I Lartë

## 2.2 MBI VERIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E KOMPETENCAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT NË LIDHJE MBI PROCEDURAT DHE KRITERET E NDJEKURA PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË FITUARA JASHTË VENDIT SI DHE ARKËTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË BUXHETIN E SHTETIT.

### 2.2.1).Auditimi mbi njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë.

Nga auditimi u konstatua se, procesi i njohjes së titujve akademikë lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, janë realizuar në bazë të urdhrave të titullarit të Ministrisë së Arsimit në mbështetje të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 29 (Procedura e delegimit; ligjit nr.9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” neni 12 ; ligjit nr.90/2012 “për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 16; ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92; Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar , duke ngritur komisione ad hoc të vazhdueshme kohë mbas kohe, për kryerjen e procedurave.

*Komisioni Ad Hoc ka për detyrë:*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

a) të marrë në shqyrtim dokumentacionin e aplikimeve për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore “Doktor”/ “Profesor”/ “Asistent/Profesor” të fituara në institucione të huaja të arsimit të lartë, të depozituara deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrimit respektiv, sipas fushave të përcaktuara në urdhër si dhe të marrë vendim mbi njohje dhe njësimin e tyre.

b) Të nënshkruajë procesverbalin në përfundim të procedurave të njohjes dhe njësimit.

Sekretariati Teknik ka për detyrë:

Dosjet e aplikimit dërgohen nga ana e protokollit tek personat përgjegjës të cilët kryejnë gjithë procedurat e verifikimit rreth vlefshmërisë së diplomave dhe statusit të institucioneve të arsimit të lartë. Pas plotësimit të një numri të mjaftueshëm dosjesh të plota për komision sekretariati teknik, inicion procedurat rreth ngritjes së komisionit ad hoc, ku për secilën fushë përcaktohet një pedagog i kategorisë “Profesor”. Anëtarët e komisionit vlerësojnë dokumentacionin dhe gjatë mbledhjes së komisionit marrin vendim rreth njohjes së tyre. Pas përpilimit të procesverbaleve, sekretariati vijon me përgatitjen e vërtetimeve të njohjes dhe rregjistrimin e vendimeve të njohjes në rregjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, të mbajtur në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga auditimi, u konstatua se, Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka përcaktuar, numrin minimal të depozitimeve deri në datën e daljes së urdhrimit si dhe koha që i duhet për shqyrtim të dokumentacionit nga komisioni, nuk është e përcaktuar, pasi kemi raste që komisioni ad hoc është ngritur për një aplikant si dhe kemi raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin dhe shqyrtimi është bërë mbas disa muaj, duke u realizuar procedura me dy standarde.

Komisioni ad hoc, është komision honorifik dhe jo me pagesë, për pasojë ka raste që anëtarët e tij, për arsye profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, gjithsesi ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes.

Më poshtë ne mënyrë tabelare kemi paraqitur ecurinë e urdhrave dhe vendimmarrjen e komisionit ad hoc dhe sekretariatit teknik.

Tabela nr.2 (ecurinë e urdhrave dhe vendimmarrjen e komisionit ad hoc dhe sekretariatit teknik)

Periudha	Urdhri	Proces-verbal	Grada	Mosnjohje /rishikim
2018	nr.169 datë 12.04.2018	Nr.1 datë 04.05.2018	16 “doktor”	2 plotësim
	nr.596 datë 21.09.2018	Nr.2 datë 17.10.2018	29 “doktor”	
	Nr.644 datë 15.12.2017	Nr.1 datë 19.02.2018	14 “doktor”	
	Nr.30 datë 16.01.2018	Nr.1 datë 19.02.2018	& 2 tituj prof./ asociuar	
<b>TOTALI/2018</b>	<b>4 Urdhra</b>	<b>4 Takime</b>	<b>61</b>	<b>2 plotësim</b>
2019	Nr.106 datë 25.02.2019	Nr.1 datë 25.02.2019	5 “doktor”	
		Nr.2 datë 24.04.2019	17 “doktor”	
	Nr.412 datë 26.07.2019	Nr.4 datë 30.07.2019 (mbledhjet janë bërë në datë 29.07.2019 & 26.07.2019)	21 “doktor”	
	Nr.503 datë 16.10.2019	Nr.5 datë 10.12.2019	15 “doktor”	6 mosnjohje
	Nr.247 datë 26.04.2019 (vetëm për 1 shtetas të huaj z.I.K)	Nr.3 datë 30.04.2019 Ambasada e rep turq në tiranë	1 “doktor”	
<b>TOTALI/2019</b>	<b>4 Urdhra</b>	<b>5 Takime</b>	<b>59</b>	<b>6 mosnjohje</b>
2020	Nr.64 datë 21.02.2020 (vetëm për z.A.Al-K) firmosur nga zv/min z.O.R	Nr.1 datë 26.02.2020	1 doktor/prof. Dhe pro i asociuar	
	Nr.151 datë 01.06.2020	Nr.2 datë 12.06.2020	22 “doktor”	2 mosnjohje
	Nr.231 datë 14.07.2020	Nr.3 datë 16.07.2020	8 “doktor”	
<b>TOTALI</b>	<b>3 Urdhra</b>	<b>3 Takime</b>	<b>31</b>	



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TOTALI		151	8
--------	--	-----	---

Nga auditimi i përputhshmërisë u konstatua se, sipas Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar ka pësuar ndryshim si vijon:

-Në Kreun IV pika 5.4, Kryetar i komisionit është zv/ministri që mbulon çështjet e arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse, në Udhëzimin nr.17, këtë rol e kryente Ministri i Arsimit.

-Për vitin 2019, Urdhrat “Për ngritjen e komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore “Doktor” të fituara jashtë vendit” respektivisht me nr.106 datë 25.02.2019;nr.412 datë 26.07.2019; nr.503 datë 16.10.2019 dhe nr.247 datë 26.04.2019, janë të miratuara dhe firmosura nga titullari (ministri) i MARS, ndërsa për periudhën janar 2020 deri në qershor 2020, janë të miratuara dhe firmosura nga zv/ministër z. Rr, në bazë Urdhër të Ministrit të MARS, me nr.47 datë 11.02.2020 “Për një ndryshim ne Urdhrit nr.587, datë 20.12.2019 “Për delegimin e kompetencave”.

**Grupi i auditimit, konstaton se krahas evidentimeve të përgjithshme, kemi hasur mospërputhshmëri në disa praktika për njohje të gradave shkencore, të cilat po i paraqesim si vijon:**

1) Në procesverbalin nr.1 datë 19.02.2018, të Komisionit ad hoc i ngritur me Urdhërin nr.644, datë 15.12.2017 “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”. Midis të tjera thuhet se “...Përsa i përket dosjeve të aplikimit të z.G. B, z.F. G dhe z.S. D mbi diplomat e lëshuara nga **Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedoni**, anëtarët e komisionit vlerësuan që dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe i mjaftueshëm për njohjen e tyre pasi nuk kishte një përgjigje zyrtare nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoni në lidhje me vlefshmërinë e këtyre diplomave. U vendos që të kërkohet informacion më të plotë drejt Ministrisë në lidhje me vlefshmërinë e këtyre diplomave dhe akreditimin e programeve të studimit të ndjekura nga aplikantët.”

Nga auditimi i përputhshmërisë , grupi i auditimit, konstatoi se në bazë të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar, citohet se në pikën 5.4 “ Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, komisione ad hoc sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë “Profesor”, i cili mbidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është Ministri i Arsimit dhe Sportit. Komisioni përkatës nuk mund të mbliidhet më vonë se 15 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri i Arsimit dhe sportit lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.”

Në rastin e njohjes së gradave shkencore, në bazë të intervistave që ka realizuar grupi i auditimit, me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit si dhe me anëtarët e sekretariatit teknik, është proceduar sipas pikës 4.1 të Kreut IV të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016 “Verifikimi i dokumentave 4.1 SENJOD-I në cilësinë e sekretariatit teknik, kryen verifikimin e autenticitetit të diplomës apo certifikatës, në rastet kur këto dokumenta nuk janë të pajisur me vulë apostile/legalizim apo nuk janë të legalizuar në vendin e origjinës sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe në rastet e dokumentacionit të lëshuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë rast, SENJOD-I kontakton me email ose në rrugë postare me institucionin që ka lëshuar diplomën apo certifikatën përkatëse. SENJOD-I mund të kërkojë dhe informacion të mëtejshëm që e konsideron të nevojshëm për vlerësim objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës apo certifikatës”.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në lidhje për këtë praktikë aplikimi, u konstatua se:

**1/a) Në datë 5 shtator 2017**, nga specialisti G. B është dërguar email Universitetit Ndërkombëtar të Strugës (UNS), duke i kërkuar konfirmimin e autenticitetit të diplomave për (z.G. B, z.F. G dhe z.S. D).

UNS ka dërguar përgjigje më **datë 7 shtator 2017**, duke bashkëshoqëruar dhe Letër Konfirmimi, duke konfirmuar autenticitetin e diplomave.

Në këtë rast jemi në kushtet, që nga sekretariati teknik është përdorur forma e komunikimit me email duke i kërkuar *informacion për vlerësim objektiv për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore, në mbështetje të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016*, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1)

*Vlen të theksohet se aplikantët kanë aplikuar në korrik të 2017 (Kjo në bazë të Formularit të aplikimit të secilit), sekretariati teknik, në shtator ka bërë verifikimin si dhe Ministri ka ngritur Komisionit Ad –Hoc me përbërje (L.N kryetar, K. K., B.D, A. B dhe K. S ) i ngritur me Urdhërin nr.644, datë 15.12.2017 “Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, është shprehur në proces-verbalin nr.1 datë 19.02.2018 se, “..për diplomat e lëshuara nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Maqedoni, dokumentacioni i tyre nuk ishte i plotë dhe i mjaftueshëm për njohje, pasi nuk kishte një përgjigje zyrtare nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut në lidhje me vlefshmërinë e këtyre diplomave.”*

Në proces verbal nuk është dhënë asnjë arsyetim, pse duhej të kërkohej zyrarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut, ndryshe nga praktikat e njohjes me vendet e ndryshme të huaja, duke vënë në dyshim vertetësinë e marrjes së gradës shkencore si dhe a ka të drejtë Komisioni Ad hoc, të shikojë legjislacionin e huaj apo të mbështetet në detyrimin ligjor që ka Ministria e Arsimit në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar.

**1/b)** Sipas praktikës me shkresë nr.3072 prot datë 28.02.2019 që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Shqiptare), ka përcjellë materialin e zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme e Maqedonisë së Veriut dhe jo nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Shkencës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo praktikë është **vetëm në gjuhën maqedonase, pa përkthim zyrtar**, ku midis të tjerave thuhet “...Ju informojmë se nga ana e Këshillit për Akreditim i është dhënë vendimi nr.15-4/2 datë 29.03.2013 për akreditimin e studimeve të ciklit të tretë trevjeçar të doktoraturës të shkencave juridike në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës.

*Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i është dhënë Vendim i përkohshëm nr.13-1647/8 datë 16.09.2014 për fillimin me punë të programit studimor për ciklin e tretë trevjeçar të doktoraturës të shkencave juridike në fakultetin juridik pranë Universitetit Ndërkombëtar të Strugës.*

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Vendimin UP1 nr.14-12426/5 datë 08.02.2019, vërteton se Vendimi I përkohshëm nr.13-1647/8 nga data 16.09.2014, që ka të bëjë me fillimin me punë të programit studimor për ciklin e tretë trevjeçar të doktoraturës të shkencave juridike në Fakultetin Juridik pranë UNS, ishte vetëm për periudhën kohore 2014/2015.”*

**1/c)** Në ecurinë e kësaj praktike, grupi i auditimit konstatoi se, më datë 10 shkurt 2020 sekretariati teknik përfaqësuar nga z.I.S pranë MARS, i dërgon email z. N.A, (përfaqësues i Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut) pranë Drejtorisë së Arsimit të Lartë, duke rikërkuar lidhur me vlefshmërinë e disa diplomave të studimit të ciklit të tretë, për aplikantët e sipër permendur “..Kemi dërguar një shkresë zyrtare mbi disa diploma të ciklit të tretë (PhD) të lëshuara nga disa Universitete në Maqedoninë e Veriut. **Për ne, informacioni i kërkuar në shkresë (vlefshmëria e diplomave dhe akreditimi i programeve) është i pranueshëm edhe nëse paraprisht dërgohet nëpërmjet emailit.**”(Vlen të theksohet se nga MARS (sekretariati teknik deri në momentin e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

hartimit të materialit të auditimit, grupit nuk ju vunë në dispozicion praktikat zyrtare të dërguara pranë MASH në Maqedoninë e Veriut).

**1/d)** Ministria e Arsimit të Maqedonisë së Veriut në komunikim me email nga n.a@mon.gov.mk, më datë 21.05.2020, për tre kandidatët në fjalë thuhet se “..Për kandidatit F. Gj dhe S. D, kanë mbaruar të njëjtin program studimor ju konfirmoj se diplomat e lëshuara më datë 02.06.2016 në emër të F . G dhe diploma e lëshuar më 25.01.2017 në emër të S .D janë të vlefshme në Republikën e Maqedonisë Veriore dhe njihen si diploma për përfundimin e ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës dhe fitojnë titullin shkencor “Doktor të Shkencave Juridike” 180 kredi niveli VIII I klasifikimit në bazë të kornizës kombëtare të kualifikimeve .(në attach keni vendimin e akreditimit) (kërkoj falje pasi vendimet e akreditimit dhe leja e punës janë gjuhën maqedonase).”,

**Pra edhe më këtë konfirmin** (sipas Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 1/e) përsëri nga Komisioni Ad hoc me përbërje (O. Rr kryetar, A. V, A Q, E.R dhe V. K) i ngritur me urdhrin nr.151 datë 01.06.2020 “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen dhe njësimin e gradave shkencore “Doktor” të fituara jashtë vendit”, sipas process verbalit nr. 2 të datës 12.06.2020, shprehen se “...përgjigjia e me email e datës 22.05.2020, konsiderohet e pamjaftueshme për të dalë në një vendim.

Grupi I auditimit, vlerëson se vendimi nga komisioni Ad hoc, duhej të ishte negativ ose pozitiv. Kjo “vendimarrje” i ka kaluar ekstremisht afatet , e cila deri tani ka marrë 3 vjet si dhe duke mos dhënë argumentime pse në këtë rastë nuk pranuar të përdoret forma e komunikimit me email me institucionin e arsimit të lartë, procedurë e përfshirë në Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016 , i ndryshuar.

**1/f)** Këto fakte i konfirmon dhe shkresa nr.3013/1 prot datë 13.07.2020 nga MARS drejtuar njërit prej kandidatëve z. D, e firmosur z. A K (Drejtor i Përgjithshëm), ku midis të tjerave thuhet se, “...bazuar në vendimarrjen e zbardhur në process verbalin nr.2, nr.3260 prot datë 12.06.2020, nuk rezulton të ketë marrë vendim përfundimtar negativ apo pozitiv mbi aplikimin tuaj për njohjen e gradës shkencore “Doktor” të fituar jashtë shtetit”.

Gjithashtu, grupi i auditimit, vlerëson se në bazë të shkresave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë së Veriut, të përcjella në MARS nëpërmjet shkresave nr.3072 prot datë 28.02.2019 dhe nr.6334 prot datë 26.04.2019 të Ministrisë për Evropën dhe Punët e jashtme, konfirmohet se diplomat e dhëna për programet e ciklit të tretë (doktoratë) nga UNS, janë konsideruar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së veriut, vetëm nëse studentët janë studentët janë rregjistruar në vitin 2014-2015. Aktualisht nuk disponohet shkresa zyrtare nga ministria përkatëse që konfirmon vitet e regjistrimit të aplikantëve të referuar emailit dhe vlefshmërinë e diplomave të fituara prej tyre, në të njëjtin format me shkresat e mëparshme.

**1/g)** Grupi i auditimit konstatoi se, duke e krahasuar me praktikën e ngjashme të aplikantit për njohje z.A. Xh, i cili e ka fituar titull “doktor” sipas proces verbalit nr.2 datë 24.04.2019 të komisionit ad hoc me përbërje (R.Sh kryetar, A. A, A. P, F. M, E.R, P.G dhe V. K) i ngritur sipas Urdhër nr.106 datë 25.02.2019. Komisionit Ad hoc, nuk i është paraqitur nga Sekretariati teknik shkresë zyrtare nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë, por një informacion nga Ministria e Jashtme e Maqedonisë së Veriut (Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut).

**Ky fakt tregon se vendimarrja është bërë me dy standarte nga MARS.**

**2.2.2) Auditimi mbi njohjen e certifikatave/diplomave të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, të njësuara nga MARS për periudhën janar 2018 deri në shtator të 2018.**

- Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i Njohjes së Diplomave, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk ekziston. Për rrjedhojë këtë detyrë e ka realizuar sekretariati teknik, i cili është ngritur kohë mbas kohe, me urdher të Ministrit të MARS, deri në momentin e miratimit të Udhëzimit nr.15



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

datë 16.04.2018, deri në momentin e ofrimit të shërbimit nga QSHA (shtator 2018), duke sjellë “mbivendosje të strukturave”.

Grupi i auditimit, gjatë procesit të auditimit në MARS, përzgjedhi në mënyrë rastësore me bazë numri aplikimet dhe dosjet e grupeve të interesit për vitet objekt auditimi, duke u përqëndruar në vendimmarrjen nga MARS, për njësimin e diplomës/ certifikatë etj, duke konstatuar se, edhe pse Udhëzimi Nr.15, datë 16.04.2018, i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr.59/2018, më datë 26.04.2018, QSHA e ka filluar aktivitetin për njohjen e diplomave në muajin shtator 2018, pra Udhëzimi nuk është zbatuar dhe Ministria e Arsimit, e cila ka vazhduar të bëjë njësimin e diplomave deri në Muajin shtator 2018.

Më poshtë po paraqesim disa nga procedurat e njësimit të certifikatave/diplomave nga MARS për periudhën e mbivendosjes prill-shtator 2018:

**1-Njohjen e diplomës së Znj.D. G, më Datë 26.07.2018,** lëshuar nga Universiteti I Firenze-s, Itali, me program 6-vjeçar, në Mjeksi dhe Kirurgji. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë.Komisioni me përbërje Z. Gj, E.I dhe D.S. Sekretariati Teknik: G.B dhe I.S.

**2- Njohjen e diplomës së Znj.B. H, më Datë 12.06.2018,** lëshuar nga Universiteti I Ghent, Belgjikë, me program 1-vjeçar, në E Drejtë Ndërkombëtare e Biznesit. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D. S. Sekretariati Teknik: A. A, M. B, A.A.

**3- Njohjen e diplomës së Znj.D. T, më Datë 16.07.2018,** lëshuar nga Universiteti I Prishtinës me program 4-vjeçar, dhe 1 –vjeçar në Drejtësi dhe e Drejtë Penale. Kjo diplomë njësohet si Bachelor dhe Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë.Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**4- Njohjen e diplomës së Znj.D., më Datë 05.06.2018,** lëshuar nga Universiteti I Zagrebit, Kroaci, me program 2-vjeçar, në drejtim Edukues I Fëmijëve Parashkollor. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë.Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**5- Njohjen e diplomës së Znj.D. P, më Datë 10.05.2018,** lëshuar nga Shkolla Profesionale, Mjekësore me program 3-vjeçar, në Infermieri. Kjo diplomë njësohet si Diplomë Profesionale në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**6- Njohjen e diplomës së Z.A. G, më Datë 09.07.2018,** lëshuar nga Universiteti I Prishtinës me program 4-vjeçar, dhe 2 –vjeçar në Sociologji-Filozofi dhe Sociologji. Kjo diplomë njësohet si Bachelor dhe Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë.Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

*Në këyë procedurë mungojnë Kredited e shënuara në diplomë.*

**7-Mosnjohjen e diplomës së Z.D. M, më Datë 06.07.2018,** lëshuar nga Trinity Laban Conservatoire of Music and Dance. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**8- Njohjen e diplomës së Z.T. M, më Datë 25.05.2018,** lëshuar nga Universiteti I Prishtinës, Kosovë me program 3-vjeçar, në Drejtësi. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**9- Njohjen e diplomës së Z.V. D. L, më Datë 25.05.2018,** lëshuar nga Politekniku I Torinos, Itali, me program 2-vjeçar, në Inxhinieri Menaxheriale. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.

**10- Njohjen e diplomës së Z.T. S, më Datë 25.05.2018,** lëshuar nga Universiteti Shën Kril dhe Metodij, Maqedoni, me program 5-vjeçar, në Stomatologji. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D.S Sekretariati Teknik : G.B dhe I.S.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

- 11-** Njohjen e diplomës së Znj.Sh.C, më **Datë 12.06.2018**, lëshuar nga Universiteti I Firenzes me program 3-vjeçar, dhe 2 –vjeçar në Shkenca dhe Teknologji Ushqimore. Kjo diplomë njësohet si Bachelor dhe Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: A. A, M. B dhe A. A.
- 12-** Njohjen e diplomës së Z.N. C U, më **Datë 16.07.2018**, lëshuar nga Universiteti I Stambollit, Turqi, me program 6-vjeçar, në Mjekësi. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: A. A, M. B dhe A. A.
- 13-** Njohjen e diplomës së Z.T. K, më **Datë 24.07.2018**, lëshuar nga Shkolla e Lartë Teknike e Rhein-Westfallen Aachen, Gjermani, me program 5.5-vjeçar, në Stomatologji. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: A. A, M. B dhe A. A.
- 14-** Njohjen e diplomës së Znj.V. H. S, më **Datë 16.07.2018**, lëshuar nga Universiteti Ege, Turqi, me program 4-vjeçar, në Sociologji. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D. S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S
- 15-** Njohjen e diplomës së Z.N.Sh , më **Datë 24.07.2018**, lëshuar nga Universiteti Amerikan I Kosovës, me program 2-vjeçar, në Studime Profesionale. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.
- 16-** Njohjen e diplomës së Znj.V. I më **Datë 05.06.2018**, lëshuar nga Universiteti I Prishtinës “Hasan Prishtina”, me program 2-vjeçar, në Shkenca Juridike. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.
- 17-** Njohjen e diplomës së Z.N. N, më **Datë 12.06.2018**, lëshuar nga Universiteti I Bologna, Itali, me program 6-vjeçar, në Mjekësi dhe me program 5-vjeçar në Kirurgji. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave dhe si Specializim Afatgjatë në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.
- 18-** Njohjen e diplomës së Z.N. S, më **Datë 06.07.2018**, lëshuar nga Politekniku I Torinos, Itali, me program 5-vjeçar, në Inxhinieri Ndërtimi. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

### **Problematika të ndryshme të hasura gjatë auditimit të dosjeve në Ministri:**

**1-**Njohjen e diplomës së Z.A. A ,më **Datë 10.04.2018**, lëshuar nga King’s College London, Mbretëri e Bashkuar, me program 3-vjeçar, në Menaxhim Biznesi. Kjo diplomë njësohet si Diplomë bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.*Në këtë procedurë mungon formulari I aplikimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, pika 1, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet I plotë nëse formulari I Aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”.*

**2-** Njohjen e diplomës së Znj.A. S, më **Datë 25.05.2018**, lëshuar nga Universiteti Shën Kiril dhe Metodij, Maqedoni, me program 5-vjeçar, në Mjeksi Dentare. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë formuali I aplikimit është I pasaktë, pasi nuk është plotësuar në fushat e detyrueshme për poltësim, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, pika 1, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet I plotë nëse formulari I Aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”.*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**3-** Njohjen e diplomës së Z.D. M, lëshuar nga Universiteti “Luigi Bocconi”, Itali me program 2-vjeçar, në Menaxhim Marketingu. Kjo diplomë njësohet si Master Shkencor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë Proces Verballi dhe Vërtetimi I Njohjes dhe Nësimit nuk përmbajnë datë se kur është marrë ky vendim.*

**4-** Njohjen e diplomës së Z.A. S, më **Datë 15.03.2018**, lëshuar nga Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë, Kosovë, me program 3-vjeçar, në Teknologji e Prodhimit Bimor. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë formuali i aplikimit është i pasaktë, pasi nuk është plotësuar në fushat e detyrueshme për poltësim, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, pika 1, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i Aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”.*

**5-** Njohjen e diplomës së Znj.V. M, më **Datë 13.04.2018**, lëshuar nga Universiteti “Ferrares”, Itali, me program 5-vjeçar, në Arkitekturë. Kjo diplomë njësohet si Master I Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: A. A, M. B dhe A .A.

*Në këtë procedurë mungon diploma që vërteton përfundimin e studimeve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, kreut III, pika 1.b. Gjithashtu mungon verifikimi I autenticitetit të diplomës të cilat realizohen nëpërmjet emailit ose në rrugë postare në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, kreut IV, pika 4.1.*

**6-** Njohjen e diplomës së Z.Xh. D, më **Datë 16.07.2018**, lëshuar nga Universiteti për Turizëm dhe Menaxhim në Shkup, me program 3-vjeçar, në Turizëm. Kjo diplomë njësohet si Diplomë bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë mungon formulari I aplikimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, pika 1, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i Aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”.*

**7-** Njohjen e diplomës së Z.M. F, lëshuar nga Universita di Camerino, Itali me program 2-vjeçar, në Kimi Metodologji Kimike të Avancuar. Kjo diplomë njësohet si Master Shkencor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D. S. Sekretariati Teknik: A. A, M.B dhe A. A.

*Në këtë procedurë Proces Verballi dhe Vërtetimi I Njohjes dhe Nësimit nuk përmbajnë datë se kur është marrë ky vendim.*

**8-** Njohjen e diplomës së Znj.M.S, lëshuar nga Universite de Poitiers, Francë me program 1-vjeçar, në Administrim Biznesi me drejtim Ekonomi, Menaxhim. Kjo diplomë njësohet si Master Shkencor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S..

*Në këtë procedurë Proces Verballi dhe Vërtetimi I Njohjes dhe Nësimit nuk përmbajnë datë se kur është marrë ky vendim.*

**9-** Njohjen e diplomës së Znj.Sh. B.-B, lëshuar nga Universiteti Shtetëror I Tetovës, Maqedoni, me program 4-vjeçar, në Ekonomi, Menaxhim. Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë mungon formulari I aplikimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, pika 1, kreut IV “Aplikimi nuk konsiderohet I plotë nëse formulari I Aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim. Në këtë rast dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me email”.*

**10-** Njohjen e diplomës së Znj.X. Ç, më **Datë 08.02.2018**, lëshuar nga “Queen Mary University of London”, Mbretëri e Bashkuar, me program 3-vjeçar, në Ekonomiks, Financë dhe Menaxhim.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Kjo diplomë njësohet si Bachelor në Republikën e Shqipërisë. Komisioni me përbërje Z. Gj, E. I dhe D S. Sekretariati Teknik: G.B, I.S.

*Në këtë procedurë mungon verifikimi I autenticitetit të diplomës të cilat realizohen nëpërmjet emailit ose në rrugë postare në kundërshtim me Udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, kreut IV, pika 4.1.*

Në lidhje mbi këto konstatimi u mbajt Aktkonstatimi nr.2 datë 15.10. 2020 me nr.4563 prot të MASR, të cilët kanë observuar me shkresë nr.4563/6 datë 23.10.2010 dhe QSHA me shkresë nr.3724/2 prot , datë 16.10.2020 si dhe observimet e MASR, në lidhje mbi Projekt Raportit përcjellë nga KLSH me shkresë nr.810/2 prot datë 19.11.2020, dërguar me shkresë të MASR nr.4563/9 datë 24.12.2020.

**Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.**

### **Pretendimi i subjektit:**

Siç është sqaruar edhe në pikën 2 të observacioneve të MASR mbi aktkonstatimin nr. 2 të grupit të KLSH, Komisioni Ad hoc **në asnjë rast** nuk është ngritur për të trajtuar vetëm një aplikim për njohjen e gradës shkencore “Doktor”. Numri më i ulët i aplikimeve për njohjen e gradave shkencore “Doktor” të fituara jashtë vendit, që ka trajtuar Komisioni Ad hoc, është 5 (procesverbali nr. 2, datë 24.04.2019). Aplikimet të cilat janë shqyrtuar individualisht nga Komisioni Ad hoc kanë qenë aplikime për **njohje të titullit akademik** të fituar jashtë vendit. Këto aplikime janë trajtuar individualisht nga Komisioni Ad hoc të përbëra nga 3 anëtarë (2 profesorë të fushës dhe kryetari i Komisionit Ad hoc) të cilët janë ngritur posaçërisht për trajtimin e aplikimit për njohjen e një titulli akademik, duke iu referuar natyrës së veçantë të këtyre aplikimeve që lipsin një trajtim më përmbytësor dhe të dedikuar nga Komisioni Ad hoc. Kjo procedurë është ndjekur për shqyrtimin e aplikimeve të z. I. K dhe z. A Al-K, të cilët janë shqyrtuar respektivisht nga Komisioni Ad hoc i ngritur me urdhrin nr. 247, datë 26.04.2019 (procesverbali nr. 3, datë 30.04.2019) dhe urdhrin nr. 64, datë 21.02.2020 (procesverbali nr. 1, datë 26.02.2020).

Në mënyrë të padrejtë po krahasohet mënyra e trajtimit të aplikimeve për njohjen e titujve akademikë me aplikimet për njohjen e gradave shkencore “Doktor” të cilët për nga natyra janë të ndryshëm nga njëri tjetri dhe kjo gjë rrjedhimisht pasqyrohet edhe në procedurat e ndjekura. Aplikimet për njohjen e gradave shkencore “Doktor” janë trajtuar gjithmonë në grup e për rrjedhojë është e pashmangshme që disa aplikime janë kryer më afër mbledhjes së Komisionit Ad hoc se disa të tjera, pasi aplikimet depozitohen gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në një ditë.

### **-Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar, numrin minimal të depozitimeve të dosjeve të aplikimeve të gradave shkencore, deri në datën e daljes së urdhrin nga ana e titullarit të MASR si dhe koha që i duhet për shqyrtimin e dokumentacionit nga komisioni Ad hoc, pasi kemi raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin dhe shqyrtimi i tyre, është bërë mbas disa muaj. Komisioni ad hoc, është komision në bazë të meritave akademike të fushës dhe jo me pagesë, për pasojë ka raste që anëtarët e tij, për arsye profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, gjithsesi ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes.

**Për sa më sipër ky observacion siç e kemi trajtuar dhe në Projektraport merret pjesërisht në konsideratë.**

### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me Aktkonstatimit nr. 2, në mungesë të Sektorit të Njohjes së Diplomave, Sekretariati Teknik është krijuar dhe e ka ushtruar detyrën në zbatim të urdhrin të ministrit nr. 663, datë 28.12.2017, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet përbërja e Komisionit të Njohjes së Diplomave, si dhe e Sekretariatit Teknik, deri në ngritjen e Sekretariatit Teknik në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Nuk rezultojnë të ketë pasur mbivendosje të strukturave as për sa i përket Komisionit të Njohjes së Diplomave e as për sa i përket Sekretariatit Teknik. Komisioni i Njohjes së Diplomave është ngritur në QSHA (me nëpunës të QSHA) me anë të urdhrin të ministrit nr. 479 datë 27.07.2018. Vetëm pas miratimit të këtij urdhri (27.07.2018) ka filluar punën Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA dhe jo në shtator 2018. Komisioni i Njohjes së Diplomave i ngritur në MASR nuk ka nënshkruar e lëshuar asnjë vërtetim njohjeje dhe njësimi pas miratimit të Urdhrin të ministrit nr. 479 datë 27.07.2018, gjë që provon mungesën e mbivendosjes të dy Komisioneve të Njohjes së Diplomave.

Gjithashtu, udhëzimi nr. 15, datë 16.04.2018 **nuk rezultojnë të përjashtojë përfshirjen e nëpunësve të MASR në Komisionin e Njohjes së Diplomave apo në Sekretariatin Teknik.** Saktësojmë se në periudhën pas miratimit të udhëzimit nr.15, datë 16.04.2018 dhe deri më 27.07.2018, Sekretariati Teknik ka qenë i përbërë nga anëtarë të MASR dhe QSHA. Në kushtet kur struktura e QSHA nuk e ka përfshirë Sektorin e Njohjes së Diplomave deri pas miratimit të strukturës përkatëse me Urdhrin e Kryeministrit nr. 146, datë 28.09.2018, përfshirja e 3 nëpunësve të QSHA në Sekretariatit Teknik ka qenë zgjidhja më optimale për fillimin e angazhimit të QSHA në procedurat e njohjes dhe njësimin. Përfshirja edhe e nëpunësve të MASR në Sekretariatin Teknik, krahas nëpunësve të QSHA-së, është realizuar në mënyrë që t'i jepet ndihma e nevojshme nëpunësve të QSHA-së në hapat e para, si dhe në kushtet kur një pjesë e aplikimeve të njohjes ishin ndjekur nga nëpunësit e MASR. Synim kryesor në gjithë procedurat e ndjekura ka qenë mundësimi i vijimësisë sa më natyrale të procedurave të njohjes dhe ruajtja e cilësisë në ofrimin e shërbimit ku një komponent i rëndësishëm është respektimi i afateve të përcaktuara në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Udhëzimin përkatës. Për procedurat e njohjes dhe njësimit të realizuara në këtë periudhë nuk rezultojnë të ketë pasur ankesa nga qytetarët të cilët kanë aplikuar për njohjen dhe njësimin e diplomave.

Po ashtu, në 18 diplomat që KLSH ka konstatuar se janë njohur në periudhën e “mbivendosjes” **nuk** rezultojnë të jetë konstatuar asnjë parregullsi në dokumentacion apo në procedurat e njohjes. Gjithashtu, vendimi më i fundit nga Komisioni i Njohjes së Diplomave me nëpunës të MASR rezultojnë të jetë me datë 26.07.2018 gjë që provon mungesën e mbivendosjes pasi nga data 27.07.2018 fillon funksionimin Komisioni i Njohjes së Diplomave me nëpunës të QSHA, i ngritur me urdhrin e ministrit nr. 479 datë 27.07.2018.

Për sa më sipër, konstatimi i pikës II, faqe 9, të Aktkonstatimit nr. 2, duhet rishikuar nga ana juaj, pasi duke iu referuar sqarimeve të mësipërme nuk rezultojnë të ketë pasur asnjë mbivendosje të strukturave që ndiqnin procedurat e njohjes dhe njësimit të diplomave të fituara jashtë vendit dhe të gjitha procedurat e njohjes janë kryer në përputhje me aktet në fuqi.

#### **-Qëndrimi i grupit të auditimit:**

në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk ekziston, për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik i ngritur me urdhër të herë pas herë nga titullari i MASR, me specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë detyra shtesë, për të cilat as nuk vlerësohen nga eprori direkt, duke e quajtur si një detyrë “honorific” dhe si një punë vullnetare, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil.” neni 62.

Gjithashtu, Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar, numrin minimal të depozitimeve të dosjeve të aplikimeve të gradave shkencore, deri në datën e daljes së urdhrin nga ana e titullarit të MASR si dhe koha që i duhet për shqyrtimin e dokumentacionit nga komisioni Ad hoc, pasi kemi raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin dhe shqyrtimi i tyre, është bërë mbas disa muaj. Komisioni ad hoc, është komision në bazë të meritave akademike të fushës dhe jo me pagesë, për pasojë ka raste që anëtarët e tij, për arsye profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, gjithsesi ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes.

**Për sa më sipër ky observacion nuk meret në konsideratë.**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	<i>Mosmiratimi i Rregullores së brendshme të QSHA-së (Aktkonstatimi nr.1)</i>
<b>Situata:</b>	Qendra e Shërbimeve Arsimore, funksionon me Rregullore të brendshme nr.1462 prot datë 02.09.2014, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, e cila nuk reflekton ndryshimet e strukturës sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, ndonëse nga QSHA me shkresën nr. 580 prot., datë 30.01.2019, është dërguar për miratim në MASR, Draft- Rregullore e brendshme, e cila nuk është miratuar nga titullari i MASR. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20.
<b>Kriteri:</b>	-Urdhri i Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”. - ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20 - Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Realizimi i detyrave funksionale pa Rregullore të brendshme , e cila nuk është miratuar nga titullari i MASR.
<b>Shkaku:</b>	MASR me pa të drejtë ka marrë kompetencën për transferimin e këtij detyrimi QSHA-së, në një kohë që këtë kompetencë e ka Këshilli i Ministrave. QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9 pika 4, por nga ana tjetër QSHA është krijuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, ku në asnjë pikë të kornizës ligjore, nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit
<b>Rëndësia:</b>	I Lartë

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	<i>Inventarizimi i dosjeve (Aktkonstatimi nr.2)</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatua se, MASR dhe QSHA, për dosjet e aplikimeve për njësimit/njohje të certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, për të cilat janë



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

	përfunduar procedurat përkatëse, kanë vetëm një bazë të dhënash të posaçme, që përmban të dhëna specifike të secilës prej dosjeve të aplikimit, por këto dosje nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar, nenet 24, 36/1, 37, 39 si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.
<b>Kriteri:</b>	<i>Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” nenet 24,36/1, 37 dhe 39.</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos arkivimi i dosjeve sjell mungesë transparence dhe mund të jetë precedent i humbjes së materialeve që përmbajnë dosjet përkatëse
<b>Shkaku:</b>	Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve
<b>Rëndësia:</b>	I Mesëm

<b>Titulli i Gjetjes 3:</b>	<i>Mungesa e sektorit të njohjes së diplomave/gradave shkencore (Aktkonstatimi nr.2)</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, <u>sektor që deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ekziston</u> , për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik, ku anëtarë janë specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë dhe këtë detyrim shtesë, për të cilin as nuk vlerësohen nga eprori direkt, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 62. Gjithashtu, komisionet ad hoc dhe sekretariati teknik, ngrihen kohë mbas kohë, me urdhër të titullarit të MASR, pra këto “struktura” nuk janë permanente. Mungesa e një strukture permanente dhe për më tepër angazhimi në komisioni i anëtarëve (profesor, pedagogë, ekspertë, etj) kundrejt asnjë pagese dhe detyrimi, ka bërë që të ketë pasur raste që anëtarë të komisioneve ad hoc, për arsye të ndryshme, profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, edhe pse ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes së gradave/titujve shkencorë.
<b>Kriteri:</b>	-Urdhri i Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, - Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil.”neni 62 - Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Vonesa në shqyrtimin e aplikimeve
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e sektorit të njohjes së diplomave/gradave shkencore
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm

<b>Titulli i Gjetjes 4:</b>	<i>Mos realizimi i vendimmarrjes për dhënie e gradave (Aktkonstatimi nr.2)</i>
<b>Situata:</b>	Për njohjen/njësimin e gradës shkencore, strukturat jopermanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, në asnjë referencë ligjore/nënligjore, nuk kërkohet të merret konfirmim zyrtar pranë Ministrisë së Arsimit, të shtetit të huaj. Në përgjithësi, MASR ka mbajtur standardin e mësipërm, ndërsa, për njohjen/njësimin e gradës shkencore të tre rasteve, të aplikuar në korrik 2017, të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës (UNS) në Maqedoninë e Veriut, në vitet 2016 dhe 2017, nga ana e sekretariatit teknik dhe komisionit ad hoc, janë mbajtur dy standarde, si vijon: - Sekretariati teknik, ka përdorur <u>formën e komunikimit me email</u> , në mbështetje të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1, duke i kërkuar informacion për vlerësim objektiv për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore, pranë UNS, më datë 07.09.2017 dhe më datë 21.05.2020. Në të dy rastet, është kthyer përgjigje miratuese si nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës si dhe në rastin e dytë është marrë edhe një përgjigje me email nga Drejtoria e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit e Shkencës në Maqedoninë e Veriut, e cila në këtë rast shërben dhe si qendra e rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC-NARIC) mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë. -Komisionet ad hoc, të ngritur, me urdhrin e Ministrit të MASR nr.644, datë 15.12.2017 dhe me urdhrin nr.151 datë 01.06.2020 me objekt “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, në procesverbalet



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

	<p>respektivë me nr.1 datë 19.02.2018 dhe nr. 2 të datës 12.06.2020, shprehen se përgjigjet me email konsiderohen të pamjaftueshme për të dalë në një vendim përfundimtar negativ apo pozitiv (konfirmuar ky fakt me shkresën nr.3013/1 prot datë 13.07.2020 të MARS) dhe për rrjedhojë kanë vendosur të kërkojnë zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut, lidhur me vlefshmërinë e disa diplomave të studimit të ciklit të tretë, për rastet e sipërpërmendur.</p> <p>Vlen të theksohet se nga MASR, deri në momentin e hartimit të materialit të auditimit, grupit nuk ju vunë në dispozicion praktikant zyrtarë të dërguara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut, por i është vënë praktika me shkresë nr.3072 prot datë 28.02.2019 që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Shqiptare), ka përcjellë materialin e zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme e Maqedonisë së Veriut dhe jo nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Shkencës së Maqedonisë së Veriut. Kjo formë komunikimi nuk është e përcaktuar në Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1. Gjithashtu, në procesverbalet, nuk është dhënë asnjë arsyetim, pse duhej të kërkohej zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut apo të merrej informacion pranë zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, ndryshe nga praktikant e njohjes me vendet e ndryshme të huaja, duke vënë në dyshim vërtetësinë e marrjes së gradës shkencore si dhe a ka të drejtë Komisioni ad hoc, të shikojë legjislacionin e huaj apo të mbështetet në detyrimin ligjor që ka Ministria e Arsimit në Republikën e Shqipërisë, sipas Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, pasi në praktikant e audituara për aplikantë të ndryshëm të cilët që kanë studiuar në vende të ndryshme të huaja për nivelin e 8, nuk është ndjekur kjo formë komunikimi, por vetëm me email pranë universiteteve apo pranë qendrës (ENIC-NARIC).</p> <p>-Gjithashtu, nga auditimi, duke krahasuar një praktikë tjetër të ngjashme, me praktikën e tre rasteve të konstatuara më lartë për njohje, ku studimet janë kryer në të njëjtin universitet, komisioni ad hoc i ngritur me Urdhrin nr.106 datë 25.02.2019 “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, i ka njohur/njësuar gradën “doktor”, në mungesë të shkresës zyrtare nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, duke u bazuar në informacionin e dhënë nga Ministria e Jashtme e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar.</p>
<b>Kriteri:</b>	-Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mos realizimit të vendimmarrjes, janë kaluar ekstremiste afatet (deri tani ka marrë 3 vjet), duke cenuar mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptar.
<b>Shkaku:</b>	Mos realizimi i vendimmarrjes për dhënien e gradave
<b>Rëndësia:</b>	I Lartë

#### IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

###### 1. Gjetje nga auditimi:

-Sipas ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, sanksionon, njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara, nga studimet të kryera jashtë vendit që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, është detyrim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) si dhe kriteret për njohjen dhe njësimin përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.

-Sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” bazuar në nenet 9,10 QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

Në vijim u konstatua se, aktet administrative të miratuara nga Ministri i MASR, në funksion të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

ligjit të mësipërm, për çështjen objekt i këtij auditimi, paraqesin problematikat si më poshtë vijon:

-Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, nr.17 datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar (i cili ka pësuar disa herë ndryshime të pjesshme, konkretisht me udhëzimet, nr. 32 datë 29.12.2017; nr.15 datë 16.04.2018; nr.5 datë 21.02.2019; nr.30 datë 30.12.2019); si dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore QSHA”, kanë bërë të mundur që, MASR të marrë me pa të drejtë kompetencën për transferimin e këtij detyrimi QSHA-së, në një kohë që këtë kompetencë e ka Këshilli i Ministrave. QSHA ndër të tjera, ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 9 pika 4, por nga ana tjetër QSHA është krijuar dhe funksionon në bazë të VKM nr. 1013 datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, ku në asnjë pikë të kornizës ligjore, nuk ka të miratuar detyrimin juridik funksional, për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.

-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në Udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016, për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, sipas Kreut II, i ka njohur të drejtën QSHA-së, të realizojë procedurën vetëm për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, të fituara jashtë vendit, ndërsa procedura për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, realizohet nga MASR, me anë të strukturave jo permanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, të cilat miratohen kohë mbas kohe me Urdhër të Ministrit të Arsimit, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 92, pasi Sektori i Njohjes së Diplomave në MASR është suprimuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.163, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

- Udhëzimi nr.17 datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1 parashikon njohjen e diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, edhe pa vulë apostile, për verifikimin e autenticitetit të diplomave, certifikata dhe gradave shkencore. Mosekzistenca e këtij elementi, ul efikasitetin e sistemeve të kontrollit si dhe lë shteg për abuzime të ndryshme.

-Udhëzimi nr.15 datë 16.04.2018, i ndryshuar, nuk ka në përmbajtje, datën e fillimit të ushtrimit të kompetencave në QSHA, por shprehet se, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare, kreu VIII (Dispozita të fundit) pika 2. Nga auditimi u konstatua se, botimi është bërë më datë 26.04.2018 në fletoren zyrtare nr. 59/2018, ndërsa procesi i njësimit të diplomave është transferuar në QSHA nga MASR, në muajin shtator 2018, duke sjellë “mbivendosje të strukturave”, pasi deri në shtator 2018, këtë funksion e ka realizuar sekretariati teknik pranë MASR.

-Udhëzimi nr.17 datë 03.08.2016 i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar, numrin minimal të depozitimeve të dosjeve të aplikimeve të gradave shkencore pranë “sekretariatit teknik” si dhe nuk ka të përcaktuar, afatet/kohën që i duhet komisionit ad hoc dhe sekretariatit teknik, për shqyrtimin e dokumentacionit, pasi konstatuam raste që aplikantët kanë dorëzuar dokumentacionin, dhe vendim marrja për njohje/njësime, është bërë mbas disa muajve.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

-MASR dhe QSHA, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik, për të iniciuar hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, në përputhje me ndryshimet e mësipërme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim, me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nenet, 9, 10 dhe 92, me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 6 (institucione varësie), me VKM nr.560 datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga QSHA” dhe me Urdhërin e Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”.

*Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (16-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### 1.1 Rekomandimi:

- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si ministria përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore, të iniciojnë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimet e VKM-së nr.371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.1013, datë 10.12.2010, të KM, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, për të bërë të mundur njohjen juridike, funksionale për atributin në fjalë nga QSHA, si struktura që realizon shërbimin e njohjes dhe njësimit e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.

- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si ministria përgjegjëse, në bazë të rolit që ka sipas ligjit të arsimit të lartë, të marrë masa për shfuqizimin e Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimit në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr.8 datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, duke hartuar dhe miratuar udhëzime që t’i shërbejnë përcaktimit të kriterëve dhe procedurave, të njohjes dhe njësimit e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit.

- Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në hartimin e udhëzimit të ri, të vendoset si detyrim procedura e vulës apostile për njësimit e të gjitha akteve (certifikata, diploma dhe grada shkencore dhe titujve akademikë), të fituara jashtë vendit, me qëllim forcimin e elementëve të vërtetësisë të dokumentave që do të njësohen.

**Deri në 3 muaj**

## B. MASA ORGANIZATIVE

### 1. Gjetje nga auditimi:

Qendra e Shërbimeve Arsimore, funksionon me Rregullore të brendshme nr.1462 prot datë 02.09.2014, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, e cila nuk reflekton ndryshimet e strukturës sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, ndonëse nga QSHA me shkresën nr. 580 prot., datë 30.01.2019, është dërguar për miratim në MASR, Draft- Rregullore e brendshme, e cila nuk është miratuar nga titullari i MASR.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 20.

*Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (18-20) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### 1.1 Rekomandimi:

Qendra e Shërbimeve Arsimore, mbas finalizimit të miratimit të VKM-së për njohjen juridike dhe funksionin e atributit të shërbimit për njohjen dhe njësimit e diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara, jashtë vendit, të marrë masa të propozojë për miratim, rregulloren e re të brendshme të saj, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë duke reflektuar ndryshimet.



### Menjëherë dhe në vijimësi

#### 2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, MASR dhe QSHA, për dosjet e aplikimeve për njësim/njohje të certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, kanë vetëm një bazë të dhënash të posaçme, që përmban të dhëna specifike të secilës prej dosjeve të aplikimit, por këto dosje nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar, nenet 24, 36/1, 37, 39 si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi. *Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (31-34) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### 2.1 Rekomandimi:

Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

### Menjëherë dhe në vijimësi

#### 3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.163 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, është suprimuar Sektori i njohjes së diplomave/gradave shkencore, sektor që deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ekziston, për rrjedhojë detyrën e realizon sekretariati teknik, ku anëtarë janë specialistë të emëruar në detyra të tjera funksionale, por që kryejnë dhe këtë detyrim shtesë, për të cilin as nuk vlerësohen nga eprori direkt, kjo në kundërshtim ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 62. Gjithashtu, komisionet ad hoc dhe sekretariati teknik, ngrihen kohë mbas kohë, me urdhër të titullarit të MASR, pra këto “struktura” nuk janë permanente. Mungesa e një strukture permanente dhe për më tepër angazhimi në komisioni i anëtarëve (profesor, pedagogë, ekspertë, etj) kundrejt asnjë pagese dhe detyrimi, ka bërë që të ketë pasur raste që anëtarë të komisioneve ad hoc, për arsye të ndryshme, profesionale nuk kanë mundur të jenë pjesëmarrës në kohë, edhe pse ky fakt nuk e ka penguar vendimmarrjen e njohjes së gradave/titujve shkencorë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (27-28) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### 3.1 Rekomandim:

MASR, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ose të shikojë mundësinë e krijimit të strukturës për njohjen së gradave shkencore brenda MASR-së, ose transferimin e këtij shërbimi pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Nëse dakordësohet që kjo strukturë të qëndrojë si pjesë e MASR, nevojitet që të përcaktohen qartë detyrat funksionale të sekretariatit teknik dhe komisioneve ad hoc, në mënyrë që të përmirësohet detyrimi i MASR, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim, si dhe në përmbushje të kërkesave të qytetarëve.

### Menjëherë

#### 4. Gjetje nga auditimi:

Për njohjen/njësimin e gradës shkencore, strukturat jopermanente - sekretariati teknik në bashkëpunim me komisionet ad hoc, në asnjë referencë ligjore/nënligjore, nuk kërkohet të merret konfirmim zyrtar pranë Ministrisë së Arsimit, të shtetit të huaj. Në përgjithësi, MASR ka mbajtur



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

standardin e mësipërm, ndërsa, për njohjen/njësimin e gradës shkencore të tre rasteve, të aplikuar në korrik 2017, të cilët kanë mbaruar studimet në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës (UNS) në Maqedoninë e Veriut, në vitet 2016 dhe 2017, nga ana e sekretariatit teknik dhe komisionit ad hoc, janë mbajtur dy standarde, si vijon:

- Sekretariati teknik, ka përdorur formën e komunikimit me email, në mbështetje të Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1, duke i kërkuar informacion për vlerësim objektiv për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore, pranë UNS, më datë 07.09.2017 dhe më datë 21.05.2020. Në të dy rastet, është kthyer përgjigje miratuese si nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës si dhe në rastin e dytë është marrë edhe një përgjigje me email nga Drejtoria e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit e Shkencës në Maqedoninë e Veriut, e cila në këtë rast shërben dhe si qendra e rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC-NARIC) mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë.

-Komisionet ad hoc, të ngritur, me urdhrin e Ministrit të MASR nr.644, datë 15.12.2017 dhe me urdhrin nr.151 datë 01.06.2020 me objekt “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, në procesverbalet respektivë me nr.1 datë 19.02.2018 dhe nr. 2 të datës 12.06.2020, shprehen se përgjigjet me email konsiderohen të pamjaftueshme për të dalë në një vendim përfundimtar negativ apo pozitiv (konfirmuar ky fakt me shkresën nr.3013/1 prot datë 13.07.2020 të MARS) dhe për rrjedhojë kanë vendosur të kërkojnë zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut, lidhur me vlefshmërinë e disa diplomave të studimit të ciklit të tretë, për rastet e sipërpërmendur.

Vlen të theksohet se nga MASR, deri në momentin e hartimit të materialit të auditimit, grupit nuk ju vunë në dispozicion praktikat zyrtare të dërguara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut, por i është vënë praktika me shkresë nr.3072 prot datë 28.02.2019 që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Shqiptare), ka përcjellë materialin e zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme e Maqedonisë së Veriut dhe jo nëpërmjet Ministrisë së Arsimit Shkencës së Maqedonisë së Veriut. Kjo formë komunikimi nuk është e përcaktuar në Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, Kreu IV, pika 4.1. Gjithashtu, në procesverbalet, nuk është dhënë asnjë arsytim, pse duhej të kërkohej zyrtarisht pranë Ministrisë së Arsimit të Maqedonisë së Veriut apo të merrej informacion pranë zyrës së Ambasadës Shqiptare në Shkup, ndryshe nga praktikat e njohjes me vendet e ndryshme të huaja, duke vënë në dyshim vërtetësinë e marrjes së gradës shkencore si dhe a ka të drejtë Komisioni ad hoc, të shikojë legjislacionin e huaj apo të mbështetet në detyrimin ligjor që ka Ministria e Arsimit në Republikën e Shqipërisë, sipas Udhëzimit nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar, pasi në praktikat e audituara për aplikantë të ndryshëm të cilët që kanë studiuar në vende të ndryshme të huaja për nivelin e 8, nuk është ndjekur kjo formë komunikimi, por vetëm me email pranë universiteteve apo pranë qendrës (ENIC-NARIC).

-Gjithashtu, nga auditimi, duke krahasuar një praktikë tjetër të ngjashme, me praktikën e tre rasteve të konstatuara më lartë për njohje, ku studimet janë kryer në të njëjtin universitet, komisioni ad hoc i ngritur me Urdhrin nr.106 datë 25.02.2019 “Për ngritjen e Komisionit ad hoc për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, i ka njohur/njësuar gradën “doktor”, në mungesë të shkresës zyrtare nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, duke u bazuar në informacionin e dhënë nga Ministria e Jashtme e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut, kjo jo në përputhje me Udhëzimin nr.17 datë 03.08.2016, i ndryshuar.

*Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (28-31) të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### 4.1. Rekomandim:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nga ana e MASR, të merren masa për zgjidhje të menjëhershme, të realizimit të vendimmarrjes, pasi janë kaluar afatet (deri tani ka marrë 3 vjet), duke cenuar mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë.

**Menjëherë**

### C. TË TJERA

Në kushtet kur:

- arkëtimi i tarifave nga shërbimet e njohjes dhe njësimit të diplomave/gradave nuk analizohet i plotë;

-nuk është reflektuar në këtë Raport Përfundimtar një analizë e detajuar mbi ecurinë e proceseve të njohjes dhe të njësimit (*sa procedura gjithsej /nga këto sa audituar/nga këto sa konstatuar shkelje/ dhe konkretisht cfare shkeljesh*), veç për QSHA-në dhe veç për MASR-në, në mënyrë që të krijohet një pamje më e plotë e këtij aktiviteti dhe procedurave të ndjekura;

Vlerësojmë se, auditimi në MASR/QSHA mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, brenda dhe jashtë vendit si dhe auditimi i plotë i sistemeve të kontrollit, përgjatë këtij procesi përfshirë edhe sistemet IT, do të jetë një drejtim i veçantë në auditimin e radhës që KLSH do të zhvillojë në MASR.

### VI.ANEKSE

Anekset japin informacion mbi të ardhurat nga tarifatat e arkëtimit të njohjes së diplomave si dhe akt rakordimet respektive me degën e thesarit, për periudhën 2018, 2019, dhe 2020 , për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të cilën grupi i auditimit, shprehet se, bankat e nivelit të dytë, ku arkëtohen tarifatat për njohje diplomash, referuar faturës për arkëtim e cila aksesohet edhe nga faqja e web e MASR, i kalojnë këto të ardhura përmes sistemit të Thesarit dhe Ministria e Arsimit kryen rakordimet mujore të ardhurave me degën e thesarit.

Të ardhurat derdhen 100% në Buxhetin e shtetit dhe sistemi i thesarit nuk jep të dhëna për numrin e aplikantëve. Në mungesë të sektorit apo drejtorisë së njohjes, e cila “kryen” procedurat, Drejtoria e Financave nuk e gjeneron këtë informacion.

## KONTROLLI I LARTE I SHTETIT



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DEGA E THESARIT TE RRET TIRANE  
 Institucioni\_1011001 MAS Muaji /Dhjetor 2018  
 AKT-RAKORDIMI PER TE ARDHURAT  
 2018 DHJETOR  
 Vlera ne Leke

Nr	Gr	Tit	Kap	Aid	Dis/ Canka	Lok	Lloji I te ardhurave	TOTALI		Pershendimit	Pjesa		Diferenca per tu autORIZUAR e papapendur	
								Arketuar	Stornuar/ sistemuar		13-11-12	14		15-13-14
1	2	3	4	5	6	7	10	11	12	13-11-12	14	15-13-14	16	17-15-16
							Gjaranca bankare (në dollarë dhe 5% për kontratat në investime)					0		0
1	465	4652	46521	4652104		0	Qera			1.007.500	1.007.500	0	0	0
2	711	7119	71196	7109500		0	Tarifë regjistri			0	0	0	0	0
3	711	7110	71101	7110103		0	Tarifë për akte administrative			129.153	129.153	0	0	0
4	711	7110	71101	7110105		0	Tarifë Shkolim			0	0	0	0	0
5	711	7110	71101	7110109		0	Konkurse pranim			0	0	0	0	0
6	711	7110	71101	7110110		0	Tarifë nga lejet për zhvillimin e kësaj te fakt			20.507.579,60	20.507.580	20.507.580	20.507.580	0,00
7	711	7110	71101	7110111		0	Tarifë shërbimi			0	0	0	0	0,00
8	711	7110	71101	7110119		0	Te ardhura			0	0	0	0	0,00
9	711	7111	71110	7111009		0	Te tjera tarifa administrative	12.000,00		617.460,00	617.460,00	0	0	0,00
10	711	7110	71101	7110199		0	Te ardhurat nga licencat për shoqëritë private	1.335.207,0		23.902.582,10	3.551.369,10	20.351.163,00	20.351.193	0,00
11	711	7110	71101	7111021		0	Te tjera te ardhura sekondare dhe pasqesa shant	60.439,20		2.214.466,30	2.214.466,30	0	0	0
12	711	7110	71110	7111099		0	Te ardhura nga shërbimet	0		0	0	0	0	0
13	711	7113	71130	7111023		0	Te ardhura nga shërbimet	0,00		1.578.444,00	1.578.444,00	0	0	0
14	711	7113	71130	7113006		0	Te ardhura nga shërbimet	0		0	0	0	0	0
15	711	7113	71130	7113013		0	Te ardhura nga shërbimet	0		0	0	0	0	0
16	711	7113	71130	7113099		0	Taksat tabelë	0		0	0	0	0	0
17	711	7113	71130	7113099		0	Te ardhura te tjera jo te tatueshme	0		0	0	0	0	0
17	719	7190	71909	7190990		0	sponsorizime grande nga organizata	0		0	0	0	0	0
18	720	7207	72070	7207010		0	Grande nga organizata ndërkomb.	1.122.750,70		92.665.991,76	92.665.991,76	92.665.991,76	92.665.991,76	0,00
19	721	7211	72111	7211100		0	Korrigitime nga vitet e kaluara	0,00		0	0	0	0	0
20	778	7780	77801	7780100		0	Totali	2.530.396,90	0,00	142.623.176,76	9.098.412,40	130.524.764,36	133.524.764,36	0,00



PERFAQESUESI I INSTITUCIONIT  
 ( Anila Shehi )

DREJTORE  
 MIRELA BIMO



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DEGA E THESARIT TE RRET TIRANE										AKT-RAKORDIMI PER TE ARDHURAT			Vlera ne Leke	
Institucioni_1011001 MAS										2019			2019	
Muaji / Dhjetor 2019										TOTALI			Fhisa	
Nr	Gr	T8	Kap	AM	Dat Qarku	Lok	10	11	12	13=11+12	14	15=13-14	16	17=15-16
Lloji / te ardhurave										Arketuar	Perfundimit	INSTITUCIONI	Audituar per pardsimit per INSTITUCIONIN	Diferenca per te audituarat e pardsimit
1	2	3	4	5	6	7	10	11	12	13=11+12	14	15=13-14	16	17=15-16
							Gjenerata bankarere debetive shuar kontrolat ne investicite	41.700	0	41.700	0	0	0	0
							Qera	0	0	0	417.040	0	0	0
							Tarifa ngritjese	0	0	0	0	0	0	0
							Tarifa per akte administrative	0	0	2.500	2.500	0	0	0
							Tarifa Shkollore	0	0	11.184.147	11.184.147	0	0	0
							Konkurse prones	0	0	0	0	0	0	0
							Tarifa nga lejet per rrugetat e tjera te fait	0	0	0	0	0	0	0,00
							Tarifa ardhurim	0	0	0	0	0	0	0,00
							Te ardhura	0	0	0	0	0	0	0,00
							Te tjera tarife administrative	0	0	50.700	50.700	0	0	0,00
							Te ardhurat nga licencat per shpertesia private	0	0	9.172.501,90	1.760.874,90	7.411.627,00	7.411.627,00	0,00
							Te tjera te ardhura selektive dhe pagues shpa	0	0	619.886,00	619.886,00	0	0	0
							Te ardhura nga shervizat	0	0	0	0	0	0	0
							Te ardh nga shuja e shpeshkimeve	0	0	2.250.770,60	2.250.770,60	0	0	0
							Leje per ushtrimit profesional	0	0	0	0	0	0	0
							Te tjera nga shuja e mardhaves	0	0	0	0	0	0	0
							Tarife tabele	0	0	0	0	0	0	0
							Sekuestime dhe zhvendime	0	0	19.500	19.500	0	0	0
							Te ardhura te tjera jo te faktshme	0	0	0	0	0	0	0
							Spontane me gronde nga organizata	0	0	0	0	0	0	0
							Gronde nga organizata ndokomb	0	0	225.957,97	17.441.340,07	17.441.340,07	17.441.340,07	0
							Konrigjime nga vlerat e kaluar	0	0	0,00	0,00	0	0	0
							<b>Totali</b>	<b>401.857,97</b>	<b>41.149.385,57</b>	<b>41.149.385,57</b>	<b>16.256.418,50</b>	<b>24.892.967,07</b>	<b>24.892.967,07</b>	<b>0,00</b>

PERFAQESUESI I THESARIT  
 PERQJUESI DREGES THESARIT

DREJTORE  
 MIRELA BIMO

PERFAQESUESI TE INSTITUCIONIT  
 ( Anlla Shehi )



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DEGA E THESARIT TE RRETTITIRANE  
 Institucioni \_1011001 MAS Muaji / Gusht 2020

AKT-RAKORDIMI PER TE ARDHURAT

2020

Vlera ne Leke

Nr	Gr	Të	Kop	Art	Dre/Darbë	Lok	Lloji / te ardhurave	TOTALI		Pjesa per BUXHETIN e SHTETIT	Pjesa	Autonuar per perform per INSTITUCIONIN	Diferenca per tu autonuarat e papendur
								GUSHT 2020	Përfundimit				
1	2	3	4	5	6	7	10	11	13=11-12	14	15=13-14	16	17=15-16
1	468	4682	46821	4682104		0	Garancia bankare e shërbimeve SPA/Per kontrole ne investimet	0	250,200	250,200	0	0	0
2	711	7119	71196	7109600		0	Qera	0	0	0	0	0	0
3	711	7110	71101	7110103		0	Tarifa regjistrimi	0	0	0	0	0	0
4	711	7110	71101	7110105		0	Tarifa per akte administrative	0	0	0	0	0	0
5	711	7110	71101	7110109		0	Tarifa Shkolli	0	0	0	0	0	0
6	711	7110	71101	7110110		0	Konkurse pranimi	0	0	0	0	0	0
7	711	7110	71101	7110111		0	Tarifa nga lejet per zhvillim e letra te flet	0	0	0	0	0	0
8	711	7110	71101	7110118		0	Tarifa shërbimi	0	0	0	0	0	0
9	711	7111	71116	7111009		0	Te ardhura	0	0	0	0	0	0
10	711	7110	71101	7110199		0	te jera tarifa administrative	0	3,000	3,000	0	0	0
11	711	7110	71101	7111021		0	Te ardhurat nga shërbimet per shoqerite private	0.00	9,326,693.60	1,088,988	8,227,705	8,210,348.00	2,017,345.60
12	711	7110	71110	7111099		0	Te jera te ardhura administrative dhe pajesia shkollore	18,000	207,497.50	179,497.50	0	0	0
13	711	7113	71130	7111023		0	te ardhura nga shërbimet	0	0	0	0	0	0
14	711	7113	71130	7113008		0	te ardh nga shërbime dhe shërbimeve	992,583.36	992,583.36	0	0	0	0
15	711	7113	71130	7113010		0	Leje per ushtrim profesionali	0	0	0	0	0	0
16	711	7113	71130	7113099		0	te jera nga shërbime dhe shërbime	0	0	0	0	0	0
17	711	7113	71130	7113099		0	Tarifa taksat	0	0	0	0	0	0
18	711	7115	71150	7115605		0	Selëmbime dhe shërbime	0	0	0	0	0	0
19	719	7190	71909	7190990		0	te ardhura te jera ja te tatimeve	0	0	0	0	0	0
20	720	7207	72070	7207010		0	shërbime grante nga organizata	0	0	0	0	0	0
21	721	7211	72111	7211100		0	Grande nga antarizata ndihmë	0	122,641,607.43	0	122,641,607	122,363,372.43	278,615.00
22	778	7780	77801	7780100		0	Kontribute nga vijat e shërbimeve	0	0	0	0	0	0
<b>Total</b>								1,020,583.36	133,421,667.69	1,531,696.50	130,889,972.02	128,573,820.43	2,296,771.60

PERFAQESUESI TE INSTITUCIONIT

( Anila Shehi )

PERFAQESUESI TE THESARIT

PERQJESUESI DEGES THESARIT

